



18



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

PRODHIMI I BRENDSHËM, ZËVENDËSIMI I IMPORTETEVE DHE NXITJA E INVESTIMEVE NË AGRO-PËRPUNIM

Tiranë, 30 Tetor 2020

Kjo dokument pune është përgatitur në kuadër të mbledhjes XXII të Këshillit të Investimeve (10 nëntor 2020), nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve, z. Elvis Zerva, ekspert ligjor dhe rregullator, znj. Elida Fara, eksperte për ekonominë, znj. Xaira Shurdha, eksperte për monitorimin dhe ndërlidhjen, nën drejtimin e Drejtores së Sekretariatit, znj. Diana Leka (Angoni). Kontribuan në material ekspertët e jashtëm, z. Shkëlzen Marku dhe z. Ilir Pilku. Redaktimi gjuhësor i materialit u realizua nga znj. Elisa Lula, oficer administrative dhe komunikimit pranë Sekretariatit. Një falenderim i veçantë për subjektet private, shoqatat e biznesit, përfaqësuesit e sektorit bankar, përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, që bashkëpunuan në kuadrin e analizës dhe konsultimit të materialit.

www.investment.com.al



LISTA E SHKURTIMEVE

AASF	Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
ALL	Monedha LEK
ASB	Projekti i BERZH-it "Këshillim për Biznesin e Vogël"
AZHBR	Agjencia Shqiptare për Zhvillimin Rural
BB	Banka Botërore
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BSH	Banka e Shqipërisë
CAP	Politikat e Përbashkëta Bujqësore
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
IFJB	Institucion Financiar Jo-Bankar
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
IPARD	Instrument për Asistencën e Para-aderimit për Zhvillimin Rural
ISUV	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë
KI	Këshilli i Investimeve
KM	Këshilli i Ministrave
KSHPO	Komisioni Shtetëror i Prodhimit Organik
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MFE	Ministria e Financës dhe Ekonomisë
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
RCGF	Fondi i Garancisë së Kredive Rurale
SKI	Sekretariati i Këshillit të Investimeve
SNZHBR	Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural
TEDA	Zonë e Lirë Ekonomike

PËRMBAJTJA

HYRJE	6
METODOLOGJIA	8
SEKTORI SHQIPTAR I AGRO-PËRPUNIMIT	10
Përshkrim i shkurtër i sektorit	10
Gjetje Kryesore	13
Potenciali i agro-biznesit	13
Sfidat në sigurimin e lëndës së parë	15
Bashkëpunim dhe integrimi i pakët në zinxhirët e vlerës	15
Sfidat kryesore në agro-përpunim	16
Sfidat e agrobizneseve me qasjen në financim	17
Aspektet Institucionale dhe Ligjore	23
Gjetjet kryesore për produktet e përzgjedhura	27
Domatet	27
Arrorët	30
Bimët mjekësore dhe aromatike	32
Lëngjet e frutave	33
Potencial i investimeve – domatja, aroret, frutat	35

REKOMANDIME	37
Bashkëpunimi, Integrimi i Zinxhirit të Vlerës dhe Furnizimi me Lëndë të Parë	37
Informacioni i tregut	38
Cilësia dhe Konkurrenca	39
Menaxhimi i Biznesit, Operacionet dhe Arsimimi	40
Çështje Institucionale dhe Ligjore	41
Aksesi në Financim	41
SUGJERIME NGA ANËTARËT E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE	42
Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri	42
Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë	43
Doni Fruits shpk	43
SHTOJCA	44
SHTOJCA 1 - Investime strategjike në BMA	44
SHTOJCA 2 - Investime Strategjike në Përpunimin e Gështenjës	45
SHTOJCA 3 - Investimet Strategjike në Përpunimin e Domates	46
SHTOJCA 4 - Investimet Strategjike në Përpunimin e Frutave	47
SHTOJCA 5 – Kosto për ngritjen e një parceleje me elikrisium	48
SHTOJCA 6 – Kosto për ngritjen e një pemëtoreje me gështenja	49
SHTOJCA 7 – Kosto për ngritjen e një parceleje me lavantël	50
SHTOJCA 8 – Kosto për ngritjen e një parceleje me sherebelë	51
SHTOJCA 9 – Kosto për ngritjen e një parceleje me portokallë	52
SHTOJCA 10 – Konto Kulture – Domate për salcë në fushë në sipërfaqjen 1ha	53
SHTOJCA 11 – Konto kulture – Molla në sipërfaqjen 1ha	55
SHTOJCA 12 – Konto kulture – Portokall në sipërfaqjen 1ha	57
SHTOJCA 13 - Pyetësori "Prodhimi i Brendshëm, Zëvendësimi i Importit dhe Nxitja e Investimeve në Agropërpunim - Supermarketet	59
SHTOJCA 14 - Pyetësori "Prodhimi i Brendshëm, Zëvendësimi i Importit dhe Nxitja e Investimeve në Agropërpunim – Markate	73
SHTOJCA 15 - Lista e Licencave dhe Lejeve për Industrinë Ushqimore	84
SHTOJCA 16 - Lista e Incentivave për Bujqësinë dhe Agro-përpunimin	87
SHTOJCA 17 - Procedurat e Investimit në Agro-përpunim	89
BIBLIOGRAFIA	93

HYRJE

Eksportet e sektorit të bujqësisë në 2019 përfaqësuan 11,8% të eksporteve totale të vendit, duke treguar një rritje të konsiderueshme krahasuar me vetëm 8,7% në 2015 dhe më pak se 3% në 2005. Vlera e përgjithshme e prodhimit të nënsektorit agro-përpunues është rritur në pesë vitet e fundit me rreth 8,4% kumulative (2019/2015) duke arritur deri në 70.031 milion lekë në 2019. Frutat, perimet dhe bimët medicinale dhe aromatike (BMA) shqiptare kanë fituar terren në Ballkanin Perëndimor dhe konsiderohen të pozicionuara mirë për të ecur më tej në tregjet ndërkombëtare me vlerë të lartë. Sektori ka dhënë gjithashtu kontribut pozitiv në eksportet e vendit gjatë periudhës janar - qershor 2020, pavarësisht nga ndikimi negativ në ekonominë shqiptare i tërmetit të 26 nëntorit 2019 si edhe i pandemisë së COVID-19 (që nga marsi 2020).

Vizioni i politikës mbi sektorin e bujqësisë detahohet në SNZHRB 2014-2020 i cili është hartuar në përputhje me qasjen e planifikimit strategjik të Bashkimit Evropian për Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP) 2014-2020. SNZHRB

2014-2020 përcakton përparësitë e politikave që promovojnë zhvillimin dhe rritjen e prodhimit bujqësor dhe synon përmirësimin e aftësive konkurruese të sektorit, harmonizimin e politikave dhe kuadrin institucional me *acquis* të BE, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe përfshirjen sociale të popullsisë rurale. Duke iu referuar konkurrencës së sektorit, një studim i fundit i Bankës Botërore¹ mbi sektorin e agro-përpunimit ka vërejtur se “*Prodhuesit shqiptarë përballen me shumë kufizime në përmbushjen e kërkesave të ngurta dhe komplekse të tregut të BE-së dhe integrimin në zinxhirët e vlerës globale, të cilat lidhen kryesisht me: (i) copëzimin e tepruar të tokës dhe paafësinë e prodhuesve për të arritur ekonominë e nevojshme të shkallës; (ii) forcën punëtore të pakualifikuar dhe proceset e prodhimit me teknologji të ulët të cilat çojnë në joefikasitet bruto gjatë gjithë*

¹ World Bank (2018). *Competitive Fruit and Vegetable Products in Albania. Finance, Competitiveness and Innovation in Focus*. World Bank Group, Washington DC
Në shtojcë jepen shembuj të kartave teknologjike që korrespondojnë me katër produktet strategjike të identifikuara të cilat mund të përdoren si pikë referimi për investime të mundshme në sektor.

procesit dhe praktikave të prodhimit, (iii) mungesën e infrastrukturës së eksportit, përfshirë shërbimet e certifikimit dhe njohuritë e tregjeve të destinacionit; dhe (iv) mungesën e qasjes në kreditim”. Komisioni Evropian në Parashikimin Ekonomik Evropian (maj 2020) deklaroi: “Megjithëse vendi do të përjetojë një turrje të ekonomisë si rezultat i COVID-19, mbështetja e madhe e ekonomisë shqiptare në bujqësi mund të frenojë disi rënien e ekonomisë pasi ky sektor do të preket më pak nga kriza e COVID-19.”

Në mbledhjen e tij të 5 tetor 2019, Këshilli i Investimeve (KI) e konsideroi agro-përpunimin si një sektor kryesor prioritar për ekonominë. Për të vrojtuar më në detaje potencialet dhe sfidat e sektorit, u krijua një grup pune i udhëhequr nga MFE dhe MBZHR, me qëllim stimulimin e debatit mbi politikat duke evidentuar pengesat kryesore dhe prioritizimin e potencialeve të investimeve (specifike) në sektor sipas perspektivës së biznesit. Në këtë kontekst, me mbështetjen e partnerëve dhe angazhimin e institucioneve, Sekretariati facilitoi punën teknike të këtij grupi, duke përshpejtuar veçanërisht procesin që

prej mars 2020 në përgjigje të situatës së krijuar nga COVID-19. Aktivitete të mëparshme të KI në këtë sektor përfshijnë trajtimin e tematikave si “Informaliteti në Bujqësi”, “Rimbursimi i TVSH-së”, “Aksesi në Financim”, Anketa “Impakti i COVID-19 mbi Biznesin”, etj.

Ky studim synon të shqyrtojë potencialet për investime në nënsektorët e *përzgjedhur* (arrorë, domate, lëngjet e frutave dhe bimët mjekësore dhe aromatike) me sugjerim të institucioneve përkatëse, përfshirë edhe sfidat kryesore të biznesit dhe nevojat për mbështetje në lidhje me informacionin mbi tregun dhe edukimin, standardet dhe certifikimin, si edhe qasjen në financim. Studimi është hartuar për të qënë kryesisht si një mjet në ndihmë të politikëbërësve në vendimarrjen e tyre dhe nuk përbën një studim të mirëfilltë kërkimor mbi sektorin/zinxhirët e vlerës. Vepimet e propozuara kanë të bëjnë me produkte specifike, të cilat mund të vlerësohen më tej si raste krahasimi për optimizimin e potencialeve të investimeve në një spekter më të gjerë. Një fokus i veçantë i është dhënë edhe produkteve shqiptare.

METODOLOGJIA

Metodologjia e studimit përfshin përdorimin e të dhënave cilësore dhe sasiore të mbledhura nga burime dytësore dhe parësore dhe bazohet në një sërë hapash të ndërmarra nga Sekretariati për të stimuluar debatin mbi prodhimin vendas, përpunimin e ushqimit dhe investimet e mundshme në agro-përpunim si më poshtë²:

- » Hulumtim³ i analizave dhe raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare, dokumenteve, ligjeve dhe akteve nënligjore në lidhje me agro-përpunimin.
- » Analizim të informacionit zyrtar nga burime dytësore (MBZHR, INSTAT, FAOSTAT, UN-COMTRADE, DPD, etj.) dhe informacionit/të dhënave kryesore nga intervistat e drejtpërdrejta me aktorët e zinxhirit të vlerës dhe ekspertët e sektorit.
- » Në vijim të Urdhërit të Përbashkët të Punës

midis MFE dhe MBZHR⁴, që synonte vlerësimin e potencialit për investime në sektorin e agro-përpunimit, tre mbledhje teknike u organizuan përmes platformës Zoom gjatë periudhës qershor-shtator 2020. Qëllimi i këtyre mbledhjeve ishte propozimi i një plani pune të koordinuar me të gjitha palët e përfshira, me qëllimin përfundimtar të krijimit të kushteve të favorshme për investime në sektorin e agro-përpunimit.

- » Një listë pyetjesh mbi “Prodhimin dhe Investimet Vendase” iu drejtua të gjithë anëtarëve dhe partnerëve të KI për të marrë këndvështrimin e tyre mbi çështje që lidhen me (1) sfidat kryesore me të cilat përballen kompanitë në agro-përpunim, (2) qasjen në financim të sektorit, si dhe (3) potencialet për investime të mundshme në sektor (me fokus arrorët, domatet, bimët mjekësore, lëngjet e frutave dhe çajrat).

² Ky studim nuk merr parasysh qasjen e ndryshme të donatorëve për këtë temë në vend, pasi nuk janë kryer analiza të hollësishme të ndërhyrjes së tyre në sektor.

³ Për më shumë detaje shiko seksionin e bibliografisë.

⁴ Për më shumë detaje vizito <https://www.investment.com.al/sq/grupi-punes-per-agroperpunimin/>.

- » Dy pyetësorë u përgatitën nga Sekretariati i KI në bashkëpunim me ekspertë të jashtëm, me synime evidentimin e potencialeve, sfidave dhe opsioneve për investim. Pyetësori i parë⁵ u hartua për kompani në fushën e prodhimit/përpunimit/tregtimit/eksportit të produkteve bujqësore. Në bazë të këtij pyetësori, u intervistuan gjithsej 42 kompani, nga të cilat 26 kompani u intervistuan ballë për ballë, ndërsa 16 kompani plotësuan pyetësorin online. Kompanitë u përzgjedhën bazuar në aktivitetin e tyre kryesor, kryesisht kompani që punojnë në agro-përpunim me fokus në njërin nga katër produktet potenciale të përzgjedhura me kujdes në grupin teknik të punës për agro-përpunimin. Një tjetër pyetësor⁶ iu dërgua online 6 pikave shpërndarjeje/supermarketeve për të marrë mendimin e tyre mbi potencialet e tregtimit të përpunimit të produkteve bujqësore brenda vendit.

⁵ Shtojca 5

⁶ Shtojca 6

- » Një kërkesë për të dhëna specifike për të eksploruar qasjen në financim të sektorit të agro-përpunimit iu dërgua Bankës së Shqipërisë, Agjencisë për Zhvillimin Rural dhe Bujqësisë (AZHBR), bankave të nivelit të dytë dhe kompanive të mikrofinancimit, si edhe tre skemave të garantimit të kredive. Banka e Shqipërisë, AZHBR, dhe 8 banka të nivelit të dytë dërguan të dhënat e tyre, ndërsa intervista të drejtpërdrejta u zhvilluan me 3 menaxherë të departamenteve të sektorit të bujqësisë në këto banka.
- » Takime nëpërmjet platformës ZOOM u mbajtën me aktorë të ndryshëm si SIPPO, ndërsa komente me shkrim u morën nga AIDA, QKR, DPD, Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare, Ambasada Italiane, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Marketingut, etj.


SEKTORI SHQIPTAR I AGRO-PËRPUNIMIT

1. PËRSHKRIM I SHKURTËR I SEKTORIT

Sektori i bujqësisë ka një rëndësi thelbësore në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Ky sektor kontribuon me rreth 18,9% në PBB-në e vendit (në 2019) dhe mbulon 36,4% të punësimit të përgjithshëm⁷. Prodhimi i përgjithshëm i bujqësisë është rritur me një mesatare prej 5% gjatë periudhës 2010-2019, ndërsa kontributi i sektorit në PBB-në kombëtare ka rënë në vitet e fundit (nga rreth 28% në 2010, në rreth 20% në 2016 dhe 18,9 % në 2019). Kontributi i bujqësisë në vlerën e shtuar bruto të ekonomisë ka qenë i qëndrueshëm ndër vite me një mesatare prej 22% për periudhën 2015-2018.

7 INSTAT (2019), Llogaritë Kombëtare, Tregu i punës

Figura 1. Kontributi i bujqësisë dhe agro-përpunimit në Vlerë e Shtuar Bruto (në %)



Burimi: INSTAT (2020)

Figura 2. Rritja reale e bujqësisë dhe agro-përpunimit (në %)





Figura 3. Kontributi i sektorit të agro-përpunimit në PBB (në %)




Burimi: INSTAT (2020)

Sipas të dhënave zyrtare, fermat në vend janë struktura të vogla, shumë të fragmentuara dhe me një prodhimtari të ulët, duke përjashtuar prodhimin e perimeve dhe ullinjve. Sipërfaqja totale e tokës bujqësore prodhuese në Shqipëri, duke iu referuar arrorëve, është rreth 700.000 ha, nga të cilat rreth 417.000 (ose rreth 60%) janë të kultivuara në zona fushore, nga të cilat rreth 179.177 ha (43%) janë toka të ujtura⁸. Numri i fermave në Shqipëri është mjaft i lartë (afërsisht 351.600 ferma) krahasuar me sipërfaqen e vendit. Strukturat e fermave janë të vogla dhe komplekse me një madhësi mesatare të fermës rreth 1,2 ha, të fragmentuara në 3-5 parcela me madhësi dhe cilësi të ndryshme të tokës. Krahasimi i thjeshtë i kontributit të sektorit në PBB (18,9%) dhe punësimi i lartë (36,4%) tregon se të ardhurat mesatare në bujqësi janë shumë më të ulëta krahasuar me sektorët e tjerë të ekonomisë. Megjithatë një numër i madh i fermave (veçanërisht në zonat e largëta rurale) prodho-

8 INSTAT (2019), Vjetari Statistikor i Bujqësisë 2019

Figura 4. Punësimi sektorial sipas qarkut (në %)




jnë kryesisht për konsum vetjak dhe bazohen kryesisht në punëtorë të papaguar familjarë ose punëtorë informalë, ato kanë një funksion mjaft të rëndësishëm në ekonominë lokale. Sipas GIZ, prodhimtaria e disa produkteve (perime, ullinj) është në të njëjtin nivel ose edhe më të lartë krahasuar me vendet fqinje. Sidoqoftë, për shkak të faktorëve të ndryshëm (d.m.th. madhësia e vogël e fermës, copëzimi i lartë, niveli i ulët i mekanizimit dhe teknologjive të prodhimit, etj.) produktiviteti i përgjithshëm për hektar mbetet më i ulët sidomos për ato kultura që në vendet e tjera rriten në sipërfaqe të mëdha⁹.

Eksportet e agrobiznesit janë rritur ndjeshëm vitet e fundit, kryesisht në perimet e freskëta dhe Bimët Mjekësore dhe Aromatike (BMA). Eksportet e sektorit të bujqësisë në 2019 përfaqësuan 11,8% të eksporteve totale të vendit, me një rritje të konsiderueshme krahasuar me vetëm 8,7% në 2015 dhe pak më pak se 3% në

9 GIZ (2019), Programi për Zhvillim të Qëndrueshëm në Zonat Rurale

2005. Eksportet e perimeve janë rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit, kryesisht nga produktet e perimeve të prodhuara në sera, të cilat përbëjnë rreth një të pestën e eksporteve totale agro-ushqimore, ku eksportet e domateve, trangujve, specave dhe pjepërave së bashku përfaqësojnë rreth 19% të eksporteve totale të sektorit të bujqë-

Figura 5. Importet, Eksportet dhe Balanca tregtare e produkteve bujqësore dhe agro-përpunuese (2015-2019, në milionë ALL)



Burimi: INSTAT dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (2020)


Industria agro-përpunuese¹⁰ është nën-sektori i përpunimit që përpunon lëndët e para dhe produktet e ndërmjetme që rrjedhin nga sektori i bujqësisë. Industria agro-përpunuese nënkupton transformimin e produkteve me origjinë nga bujqësia, pylltaria dhe peshkimi. Në Shqipëri, përpunim më i avancuar i produkteve ushqimore realizohet nga rreth 2.476 kompani¹¹, nga të cilat:

¹⁰ Aktiviteti ekonomik i përpunimit, sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike, NACE Rev. 2, INSTAT: "Përpunimi përfshin transformimet fizike dhe kimike të materialeve, substancave ose përbërësve në një produkt të ri. Përpunimi i ushqimit përfshin përpunimin e produkteve bujqësore, pyjore dhe të peshkimit në ushqime dhe pije për njerëzit ose kafshët, dhe përfshin gjithashtu prodhimin e produkteve të ndryshme të ndërmjetme që nuk janë ushqime direkte. Aktiviteti shpesh prodhon produkte të paketuara në vlerë më të madhe ose më të vogël".

¹¹ MBZHR, të dhëna të ofruara për këtë studim.


sisë. Gjithashtu, Shqipëria ka një traditë të fortë në prodhimin dhe eksportimin e BMA-ve. Më shumë se 95% e e BMA që kultivohen dhe mbledhen në vend, eksportohen (duke kontribuar me rreth 11,8% në eksportet totale të bujqësisë), duke e kthyer Shqipërinë në një faktor të rëndësishëm ndërkombëtar në këtë sektor.

Figura 6. Pjesa në totalin e eksporteve e produkteve kryesore të eksportuara (2015-2019, në milionë ALL)



rreth 65,4% merren kryesisht me përpunimin e miellit, bukë, makarona, biskota dhe ëmbëlsira; rreth 12,8% me përpunimin e produkteve të bulmetit; rreth 5,4% me mish dhe produkte peshku; rreth 4,2% me prodhimin e verës dhe pijeve alkoolike; vetëm rreth 1,2% e kompanive merren me përpunimin e frutave, perimeve dhe MBA; ndërsa pjesa tjetër merret me prodhim ujë mineral, pije freskuese dhe produkte të tjera të pakatëgorizuara. **Vlera e përgjithshme e prodhimit të nënsektorit agro-përpunues është rritur në pesë vitet e fundit me rreth 8,4% (kumulative 2019/2015) duke arritur deri në 70.031 milion ALL në 2019.**

Figura 7. Numri i kompanive në agro-përpunim në vite (2015-2019)




Burimi: MBZHR (2020)

Prodhimi organik¹². Prodhimi organik ka filluar të fitojë një farë interesi në disa prodhues të stimuluar si nga potenciali i eksportit, ashtu edhe nga kërkesa në rritje e konsumatorit vendas. Gjatë vitit 2018, mbështetja për bujqësinë organike është shtrirë në certifikim të fermave dhe kalimin e disa fermave drejt prodhimit organik. Numri i përfituesve dhe sasia e mbështetjes sipas kësaj skeme është rritur¹³. Sipas të dhënave të MBZHR, ka 81 ferma në Shqipëri që kanë marrë certifikim organik në vitet e fundit. Sipërfaqja totale e tokës së certifikuar si organike ka arritur në rreth 648.292 ha tokë pyjore (nga të cilat 346.518 ha të dedikuara për mbledhjen e BMA të egra dhe rreth 3.250 ha pyje e gështenja) dhe rreth 528,5 ha tokë bujqësore të kultivuar dhe 94,3 ha të tjera janë aktualisht në proces certifikimi. Pjesa më e madhe e kësaj zone të certifikuar (rreth 82%) i kushtohet kultivimit të BMA dhe rreth 9% kulturave të përhershme (kryesisht ullishte).

¹² Prodhimi organik është një sistem që integron "praktikat kulturore, biologjike dhe mekanike që nxisin riciklim të burimeve, promovojnë ekuilibrin ekologjik dhe ruajnë biodiversitetin". (Burimi: Programi Organik Kombëtar)

¹³ Raporti i Progresit i BE, 2019/2020

Figura 8. Vlera e prodhimit në agro-përpunim dhe numri i të punësuarve sipas viteve (2015-2019)




2. GJETJE KRYESORE

Në përpjekje me objektivat e këtij studimi, në një përpjekje për të identifikuar problemet kryesore në lidhje me optimizimin e potencialeve të investimeve në sektorin e agro-përpunimit (fokusi: domate, arrorët, BMA dhe lëngjet e frutave) dhe identifikimin e rekomandimeve të nevojshme, Sekretariati i KI (bazuar mbi rishikimin e raporteve/studimeve të ndryshme të mëparshme dhe analizën e të dhënave të mbledhura përmes bashkëpunimit me institucionet qeveritare, pyetësorëve dhe intervistave me aktorët kryesorë lokalë), ka identifikuar gjetjet kryesore si më poshtë:

a. Potenciali i agro-biznesit

Në Shqipëri, perimet, frutat dhe BMA-të mund të konsiderohen si nënsektorët kryesorë të sektorit të bujqësisë. Të tre këta nën-sektorë kanë pësuar një rritje të ndjeshme në vitet e fundit, si përsa i përket zonave të mbuluara me këto kultura, ashtu edhe për prodhimin e përgjithshëm. Kërkesa e lartë për eksport, kushtet e favorshme klimatike për prodhimin e lëndëve parësore, shoqëruar me skema të ndryshme mbështetëse nga qeveria shqiptare (IPARD dhe agjenci të tjera donatore) kanë luajtur një rol të rëndësishëm në stimulimin e zgjerimit të këtyre nënsektorëve.


Figura 9. Përqindja e kompanive të intervistuar që e konsiderojnë agro-përpunimin si potencial për investime



Burimi: Pyetësorë të Sekretariatit të KI


Industria agro-përpunuese konsiderohet se ka potenciale për investime dhe rritje të kontributit në zhvillimin e ekonomisë së vendit. Pjesa dërmuese e kompanive të intervistuar (37 nga 42 ndërmarrje) konsiderojnë që agro-përpunimi ka potencial dhe mundësi të mira investimi në Shqipëri. Ndër produktet e zgjedhura, gështenjat, domatet dhe BMA-të konsiderohen nga kom-

Figura 11. Listoni sipas rëndësisë nevojat kryesore në zgjerim të aktivitetit tuaj




Burimi: Pyetësorë të Sekretariatit të KI

Figura 10. Përqindja e kompanive të intervistuar mbi produktet kryesore potencial për eksport



panitë e intervistuar si tre produktet kryesore që kanë më shumë potencial për agro-përpunim. Produkte të tjera të konsideruara si potenciale përfshijnë: vaj ulliri, mjaltë, boronicë, luleshtrydhe dhe shëgë. **Ndërsa pengesat kryesore për investimet e reja konsiderohen kryesisht aksesit në financim, aksesit në lëndët e para dhe copëzimi dhe mungesa e bashkëpunimit.**


Figura 12. Cilat mendoni se janë pengesat kryesore për investime të reja në aktivitetin tuaj?



b. Sfidat në sigurimin e lëndës së parë

Shumica e përfaqësuesve të kompanive eksportuese dhe supermarketeve të intervistuar deklaruan vullnetin e tyre për të rritur furnizimet nga tregu i brendshëm nëse kompanitë vendase do të mund të siguronin sasi të larta të produkteve me standardet e kërkuara dhe çmime konkurruese. Tregu i produkteve vendase konsiderohet ende si shumë i fragmentuar, me

Figura 13. Problematikat kryesore në lidhje me “Sigurimin e lëndës së parë në vend”



Burimi: Pyetësorë të Sekretariatit të KI


c. Bashkëpunim dhe integrimi i pakët në zinxhirët e vlerës

Agrobiznesi në vend ende vuan nga bashkëpunimi i kufizuar dhe lidhjet e dobëta midis prodhimit primar dhe përpunimit. Ndërsa sektori i agrobiznesit është shumë i rëndësishëm për ekonominë, studime të ndryshme konfirmojnë se zinxhiri i vlerës nuk është i organizuar mirë, ka lidhje të dobëta midis prodhuesve të produktit primar dhe përpunuesve të këtyre produkteve. Sipas BERZH¹⁴, ka shumë pak bashkëpunime zyrtare në formën e grupimeve

14 BERZH, Strategjia e re e Agrobiznesit

kosto të lartë, cilësi jo uniforme të produktit dhe shpesh në sasi të pamjaftueshme. Nga analiza e të dhënave të siguruar gjatë intervistave, rezultojnë se sfidat kryesore që hasin kompanitë në sigurimin e lëndëve të para nga prodhuesit primar lidhen kryesisht me: (i) kostot e larta të lëndëve të para vendase (60%); (ii) mungesa e likuiditetit për të blerë lëndë të parë (48%); dhe (iii) standarde, cilësi dhe sasi të pamjaftueshme të lëndëve të para në dispozicion.

Figura 14. Antarësimi i kompanive të intervistuar në kooperativa/organizime të ngjashme




të prodhuesve ose kooperativave dhe shpesh, prodhuesit përballen me vështirësi dhe një hyrje të pasigurt në treg për shkak të marrëdhënieve të paqëndrueshme dhe jo-bashkëpunuese midis fermerëve dhe përpunuesve ose tregtarëve me shumicë. Kjo u konfirmua edhe gjatë intervistave, ku shumica e kompanive të intervistuar nuk besojnë në kooperativa dhe/ose nuk janë në dijeni të ekzistencës së organizatave të tilla (vetëm 7 nga 42 kompani deklaruan se besojnë në të tilla organizime). Modelet joefikase të bashkëpunimit ndërmjet fermerëve do të rezultojnë në pamjaftueshmëri asetesh, ekonomi shkalle, kthim dhe biznese jo konkurruese.

d. Sfidat kryesore në agro-përpunim

Pjesa dërrmuese e kompanive agro-përpunuese shqiptare janë ndërmarje të vogla dhe të mesme, të angazhuara në një kompleksitet aktivitetesh me teknologji modeste. Sektori përfaqësohet me një total prej 2.476 kompani¹⁵, të vendosura në rajone të ndryshme të Shqipërisë, kryesisht në afërsi të burimeve përkatëse të furnizimit. Një shumicë e madhe e ndërmarrjeve janë të përfshira në disa hapa në të gjithë zinxhirin e vlerës, nga prodhimi, grumbullimi të përpunimi dhe tregtimi, përfshirë tregjet lokale dhe të eksporteve. Me përjashtim të disa ndërmarrjeve të mëdha aktive në BMA dhe nënsektorin e mishit dhe qumështit, shumica e ndërmarrjeve agro-përpunuese janë biznese të vogla, me teknologji mjaft modeste, kapacitete relativisht të ulta përpunuese dhe prodhojnë

15 MBZHR, (2020)

Figura 15. Problematikat kryesore në lidhje me “Përpunimin e produktit dhe tregtimin”




Burimi: Pyetësorë të Sekretariatit të KI

kryesisht për tregun lokal. Rreth 33% e kompanive të intervistuar deklarojnë se përballen me probleme të lidhura me teknologjinë dhe rreth 31% janë përballur me një konkurrencë të padrejtë nga importet.

Sektori i agrobiznesit në përgjithësi, është një nga sektorët që vuan më shumë nga informaliteti, duke krijuar sfida të rëndësishme për kompanitë në sigurimin e produkteve vendase. Pothuajse dy të tretat e kompanive të pyetura (59%) deklaruan se niveli i lartë i informalitetit në tregun e brendshëm përbën një sfidë të rëndësishme për ta për të rritur më tej furnizimin me produkte vendase. Ai gjithashtu krijon sfida shtesë, të tilla si disponueshmëria e kufizuar e kolaralit, nivele të ulëta të aftësisë financiare dhe marrja e kufizuar e transaksioneve moderne¹⁶.

16 Banka Botërore (2020). Albania Credit Guarantee Scheme Assessment. The World Bank Group. Finance, Competitiveness and Innovation Global Practice

Figura 16. Si e siguron tregun për shitjen e produktit tuaj (rrjeti i shpërndarjes)? (në %)



Me përjashtim të BMA, shumica e produkteve shqiptare eksportohen në vendet e Ballkanit Perëndimor si edhe në vende të BE me fuqi blerëse më të ulët, duke përfituar kështu nga çmime mjaft të ulëta. Ndërsa pothuajse 70% e kompanive të intervistuar deklaruan se aksesin në tregje të reja/më të mira është një nga nevojat e tyre më të rëndësishme, rreth 26% e kompanive të intervistuar po përballen me vështirësi të konsiderueshme në hyrjen në tregje dhe rreth 29% në krijimin e besimit me blerësit/konsumatorët dhe sigurimin e besueshmërisë së blerësve të huaj ndaj produktit shqiptar. Kompanitë ankohen gjithashtu për mungesën e informacionit nga institucionet publike mbi tregjet e reja potenciale dhe mbështetjen e kufizuar për promovimin e produkteve shqiptare siç është edhe pjesëmarrja dinjitoze në panaiet ndërkombëtare.

Cilësia e produkteve/standardet janë një faktor i rëndësishëm që mund të rrisë aftësinë konkurruese të agrobiznesit shqiptar në tregjet lokale, rajonale dhe ndërkombëtare. Ndërsa teknikat e trajtimit dhe menaxhimit të magazinimit para vjeljes janë të rëndësishme (për ruajtjen dhe rritjen e cilësisë së produktit dhe lehtësimin e presionit mbi shitjet e detyruara me çmime të ulëta), teknikat pas vjeljes, si dhe informacioni mbi kërkesat e tregjeve në lidhje me cilësitë dhe sasi të kërkuara të produktit mbetet një sfidë për të gjithë aktorët e zinxhirit të vlerës. Gjithashtu, shumë prej aktorëve të zinxhirit të vlerës nuk kanë njohuri mbi kërkesat që lidhen me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë, si dhe mbi praktikën e mira bujqësore apo edhe konsideratat tjera agro-mjedisore¹⁷.

17 GIZ (2019) Programi për Zhvillimi të Qëndrueshëm në zonat rurale

Konkurrenca e sektorit të agro-përpunimit dëmtohet gjithashtu edhe si rezultat i kostove të larta të paketimit (p.sh. paketimi i qelqit, i cili është një produkt importi i tak-suar) duke i bërë produktet e përpunuara të paketuara më pak konkurruese si në tregjet e brendshme ashtu edhe në ato ndërkombëtare.

e. Sfidat e agrobizneseve me qasjen në financim

Nga 42 kompani të intervistuar, 66% e tyre rendisin “Qasjen në Financim” si faktorin e tretë më të rëndësishëm që ndikon në menaxhimin e biznesit të tyre.

Duke iu referuar Strategjisë së Agrobiznesit të BERZH: **“Ka një disponueshmëri të kufizuar të produkteve të përshtatshme, të përballueshme dhe në kohë të produkteve kreditore për të financuar përmirësime përgjatë zinxhirëve të vlerës, veçanërisht për NVM-të dhe aktorët në shkallë të vogël përgjatë zinxhirit të vlerës së bujqësisë”**¹⁸. Gjithashtu, sipas raporteve ndërkombëtare, përmirësimi i qasjes në financim në Shqipëri vlerësohet i ulët në vitet e fundit, 3,26 me 3,32 (2019/2016).¹⁹ Shqipëria renditet 102/141 për sa i përket Sistemit Financiar (Maqedonia e Veriut renditet e 83a; Serbia e 82a, Bosnja Hercegovina e 80a, Mali i Zi i 44i).²⁰ Në 2019, 1,6% e totalit të portofolit të huave të biznesit iu akorduan kompanive në sektorin e bujqësisë (përfshirë bujqësinë, pylltarinë dhe peshkimi) dhe 15,2% i shkoi kompanive në industrinë e përgjithshme të përpunimit në vend (përfshirë dhe agropërpunimin).

18 BERZH Strategji për Sektorin e Agrobiznesit 2019- 2023

19 OECD (2019). Aksesin në financa për NVM-të (Dimensioni 6) në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë

20 WEF (2019). Raporti i Treguesve të Konkurrueshmërisë

Për periudhat 2017-2020, konstatohet një trend rënës në huadhënie nga sektori bankar privat: rreth 5% ulje e kreditimit për kompanitë që operojnë në sektorin e bujqësisë; dhe 22% ulje e kreditimit për kompanitë në industrinë e përpunimit²¹. Në vitin 2019, gjithsej portofoli i huave nga Institucionet Financiare Jo-Bankare (IFJB) ishte 35,46 miliardë ALL. Rreth 5% e këtij portofoli u është dhënë kompanive që operojnë në sektorin e Bujqësisë nga kompanitë e kursim-kreditit dhe rreth 7% nga Institucionet e tjera jo bankare si NOA/Fed Invest/Besa Foundation sh.a./UniFin/CFFA²². Gjithashtu, nivelet e refuzimit të kredive janë veçanërisht të larta për bizneset bujqësore e sipërmarrjet e vogla.²³ Sipas të dhënave nga pasqyrat financiare të raportuara në QKB (2019) nga 84 kompani: nga totali i portofolit të huave të biznesit 2019 në sektorin bankar, 0,3% iu është dhënë 61 kompanive në sektorin e prodhimit bujqësor dhe 0,7% të këtij portofoli u është dhënë 23 kompanive që operojnë në sektorin e agro-përpunimit.²⁴

Skemat e sigurimeve bujqësore janë një mjet akoma i pazhvilluar në drejtim të minimizimit të efekteve të pafavorshme të rreziqeve bujqësore. Ato adresojnë prodhimin bujqësor dhe risqet e prodhimit kryesisht për shkak të klimës së pafavorshme.²⁵ Riske të tilla e bëjnë prodhimin bujqësor të paqëndrueshëm nga viti në vit,

duke ndikuar në të ardhurat dhe mirëqenien e prodhuesve, duke e bërë sektorin të rrezikshëm në aspektin financues. Ndërsa nga njëra anë, zhvillimi i skemave të sigurimit bujqësor do kishte impakt pozitiv në rritjen e qasjes në finanim përmes uljes së nivelit të riskut të këtyre aktiviteteve, nga ana tjetër kompanitë bujqësore e shohin këtë mjet më shumë si një rritje e shpenzimeve, përveç rastit nëse qeveria ndërhyr duke mbuluar pjesërisht primin e sigurimit sikurse po ndodh edhe në vende të rajonit.

Sa i përket aksesit fizik dhe afërsisë së sektorit bankar me kompanitë, për periudhën 2015-2019 konstatohet një trend rënës i pranisë gjeografike të bankave tregtare kryesisht referuar numrit të bankave, një-sive të shërbimit dhe numrit të punonjësve të bankave që u shërbejnë bizneseve. Ka një trend rritës prej 19% nga Insitucionet Financiare Jo Bankare për t'u zgjeruar gjeografikisht, por këto institucione u japin hua kryesisht fermerëve dhe prodhuesve të vegjël. Nga ana tjetër, numri dhe vëllimi i transaksioneve bankare online (*e-banking*) dhe në aplikacionet në celular (*mobile banking*) është rritur me më shumë se 100% duke i dhënë më shumë mundësi bizneseve që operojnë larg bankave. Ekziston tashmë edhe një degë lëvizëse nga Credins Bank ideuar t'u vijë më pranë bizneseve në zonat rurale.

21 Raporti Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë 2019 (dhe) INSTAT (2014). Nomenklatura e Aktiviteteve Ekonomike


22 Raporti Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë 2019 (dhe) INSTAT (2014). Nomenklatura e Aktiviteteve Ekonomike

23 Dushku, E.; Ceca, K. (2017). Ndërmarrjet Bujqësore në Shqipëri dhe Financimi i tyre, Banka e Shqipërisë

24 Banka e Shqipërisë (2019) Raporti Mbikëqyrës (dhe) Departamenti i Statistikave Financiare në Tetor (2020)

25 FAO Inovacionet e Sigurimeve (2005)


Figura 17. Aksesit Fizik 2015-2019



Burimi: SKI bazuar në informacionin e Bankës së Shqipërisë, Departamenti i Statistikave Financiare (Tetor 2020). Raporti i Mbikëqyrjes BSH 2019

Nga këndvështrimi i kompanive, ndërkohë që maturiteti i kredive është përmirësuar në vitet e fundit, kompanitë vazhdojnë të jenë dukshëm të pakënaqura me garancitë/kolateralin e kërkuar, si dhe kohën e analizës dhe miratimit të kredisë. Rreth 44% e ndërmarrjeve të intervistuar, kishin marrë financim bankar për investime, 38% kishin marrë paradhënie bankare dhe 18% kishin marrë kredi për likuiditet (kapital qarkullues). Nga ato që kishin marrë një kredi bankare, rreth 67% e tyre ishin pozitivë në lidhje me kushtet e huasë, rreth 48% në lidhje me normat e interesit, rreth vetëm 43% ishin pozitivë në lidhje me procedurat. Bilanci ndryshon **në lidhje me kolateralin e kërkuar për të cilin 57% dhanë një vlerësim negativ dhe 55% e tyre dhanë po të njëjtin vlerësim për kohën e miratimit të kredisë.**

Figura 18. Nëse keni marrë një kredi, si e vlerësoni mbështetjen e dhënë nga bankat në këtë drejtim?




Burimi: Pyetësori i SKI

Koment nga banka të nivelit të dytë:

....Një problematikë e evidentuar lidhet me një ndërhyrje të mundshme në kontratën e Granteve midis AZHBR-së dhe Fermerëve/kompanive - Neni 4 pika 14: "Përfutuesi është i detyruar të mos tjetërsojë, të marrë ose japë me qera objektin e investimit të kësaj kontrate për sa kohë ajo është në fuqi (5 vite)". Sipas këtij neni, klienti investimin e ri nuk mundet ta vendosë si garanci në favor të një banke. Nëse kypnen riformulohet duke shtuar: "Lejimi i vendosjes si garanci vetëm për bankat apo institucionet financiare ose lejimi me shkresë më vete për vendosjen si garanci" do lehtësohej kreditimi nga bankat në rastet e klientëve të tillë....


Kompanitë kanë besim në potencialin e sektorit të agro-përpunimit dhe ato janë të gatshme të investojnë jo vetëm me burimet e tyre personale por edhe me hua bankare dhe fonde të tjera mbështetëse. Shumica e kompanive të intervistuar (36 nga 42 ndërmarrje) kanë bërë investime të konsiderueshme (58% kanë bërë investime deri në 100.000 Euro) në 24 muajin e fundit kryesisht me burime personale (41%) dhe hua bankare (31%). Në lidhje me burimet kryesore të financimit, rreth 41% e këtyre investimeve janë bërë me burime personale/të brendshme, të ndjekura nga kreditë bankare (rreth 31%); grante për zhvillim (rreth 8%) dhe pak prej tyre (rreth 8%) me fonde nga partnerët e tyre ndërkombëtarë.

Figura 19. Burimet kryesore të financimit për investimet në 24 muajt e kaluar (në %)




Burimi: Pyetësori i SKI

Figura 20. Burimet kryesore të financimit për investimet e planifikuara në 24 muajt e ardhshëm (në %)



Në total 33 nga 42 ndërmarrje deklaruan se planifikojnë të bëjnë investime të konsiderueshme në 24 muajt e ardhshëm, (46% deri në 100.000 Euro) kryesisht me subvencione (32%), burime personale (30%) dhe hua bankare (30%). Rreth 30% e tyre planifikojnë të përdorin burimet e tyre personale/të brendshme, rreth 30% kredi bankare dhe 32% planifikojnë të aplikojnë për skemat e granteve qeveritare. **Burimet kryesore të informacionit të bizneseve agro-përpunuese në lidhje me skema aktuale mbështetëse, rezulton të jenë (i) fushatat promovuese të organizuara nga in-**

Figura 21. Burimet kryesore të informacionit mbi skemat e financimit të MBZHR/AZHBR/AIDA




Burimi: Pyetësori i SKI

Nga analizimi i të dhënave (deri në dhjetor 2019) për dy fazat e aplikimeve në programin IPARD, rezulton se në total nga të dy thirrjet²⁶ IPARD përfituan vetëm 15% të bizneseve agro-përpunuese aplikuese. Në thirrjen e parë IPARD, u dhanë 30% e vlerës së kërkuar nga 99 aplikantë. Në thirrjen e dytë, vetëm 9% e vlerës së

26 Nëntor 2018 – Janar 2020 (Thirrja e parë IPARD II, 30 nëntor 2018 - 30 janar 2020, Thirrja e dytë 30 tetor 2019 - 15 janar 2020)

stitucionet përkatëse dhe (ii) njohjet personale, ndërsa shoqatat e biznesit janë më pak aktive në shpërndarjen e informacionit. Ndër 40 ndërmarrjet që pretenduan të ishin në dijeni të skemave të mbështetëse nga MBZHR/AZHBR/AIDA, rreth 70% e tyre kishin aplikuar për mbështetje. Ndër ata që kanë zgjedhur të mos aplikojnë, arsyet kryesore të deklaruara janë: (i) çështjet e pronës së tokës; (ii) mungesa e besimit për t'u zgjedhur/miratuar; dhe, (iii) procedurat e ndërlikuara të aplikimit dhe vështirësitë në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar.

Figura 22. Burimet kryesore të informacionit mbi skemat e financimit të AASF/ASB/RCGF/Programi Italo-Shqiptar për Zhvillimit e NVM-ve



kërkuar nga 142 aplikantë. Thirrja e dytë kishte interes më të madh se e para nga ana e bizneseve, por përfituan vetëm 8% e bizneseve agro-përpunuese aplikuese. Nga të dy thirrjet IPARD, frutat dhe perimet janë sektori që përfitoi më shumë, me përkatësisht 45% në thirrjen e parë dhe 11% në thirrjen e dytë. Sektori me përfitimet më të ulëta nga të dy thirrjet ishte bimët medicinale, i cili përfitoi vetëm në thirrjen e parë me vetëm 2% të gjithë vlerës së akorduar në këtë thirrje.

Figura 23. VLERA E PËRFITUAR NGA IPARD





Figura 24. Nr i Përfituesve nga IPARD




Burimi: SKI bazuar në të dhënat e AZHBR, Departamenti i Riskut, Parandalimit të Shkeljeve, Analizës dhe Raportimit, Tetor 2020

Lidhur me skemat mbështetëse të granteve të AZHBR, numri dhe vlera më e madhe prej (32%) u është dhënë kompanive agro-përpunuese që operojnë në sektorin e frutave & perimeve (përfshirë dhoma frigoriferike e qendra grumbullimi). Blegtoria dhe akuakultura janë përfituesit e dytë në radhë me 23% të vlerës totale, rreth 9% i është

akorduar sektorit të bimëve mjekësore”, rreth 2% lëngjeve të frutave e verës”, dhe vetëm 1% i është dhënë sektorit të arrorëve. Pjesa tjetër e granteve janë grupuar nën zërin “Bujqësia në përgjithësi”, duke përfshirë të gjithë sektorët e bujqësisë (bazuar në kodet e investimeve të përdorura nga AZHBR).

Figura 25. SKEMA AZHBR 2013 - 2019




Burimi: Sekretariati i KI bazuar në të dhënat e mbledhura nga AZHBR, Departamenti i Riskut, Parandalimit të Shkeljeve, Analizës dhe Raportimit, Tetor 2020

Një trend i ngjashëm vihet re edhe tek mbështetja e dhënë nga tre prej Skemave të Garancive të Kredisë në dispozicion për Agrobiznesin - AASF, KFW RCGF, Programi Italo- Shqiptar për zhvillimin e NVM-ve. Një total prej 179 biznesesh agro-përpunuese përfi-

tuan nga këto skema të garantimit të kredisë dhe sektori që përfitoi më shumë ishte fruta dhe perime, i ndjekur nga qumështi e nënproduktet e tij. Sektori që përfitoi më pak nga të gjitha skemat, ishte arrorët i ndjekur nga ulliri & vaji i ullirit.

Figura 26. Vlera e mbështetur nga skemat/fondet e garancive (Aktivitet Ekonomik-EURO)



Burimi: SKI bazuar në të dhënat e AASF, RCGF, Programi Italo-Shqiptar për Zhvillimin e NVM-ve, Tetor 2020

Çështjet e lidhura me pronën dhe paqëndrueshmëria e furnizimit dhe e cilësisë së lëndëve të parashfaqen si një pengesë kryesore për investimet e reja për shumicën e firmave të intervistuar. Për më tepër, kjo vështirëson edhe aplikimet për grante, hua dhe certifikata të BE-së.²⁷ Sipas studimeve ndërkombëtare, sfidat mbi sigurimin e burimeve të nevojshme financiare shtohen gjithashtu nga (i) mungesa e të kuptuarit të produkteve financiare dhe përfitimeve të mundshme që mund t'i vijnë biznesit nga këto propozime financiare, (ii) mungesa e informacionit dhe njohurive mbi aplikimin dhe qasjen në fonde²⁸, (iii) mungesa e kapaciteteve teknike në

përgatitjen e planeve të biznesit si nga prodhuesit ashtu edhe nga përpunuesit²⁹.

f. Aspektet Institucionale dhe Ligjore

» **Çfarë është evidentuar në raportet ndërkombëtare në lidhje me sektorin?**

Më poshtë janë disa nga çështjet më tipike që janë evidentuar dhe ngritur gjatë intervistave të kryera në prill 2019 nga ekipi i BB me sipërmarrës shqiptarë, firma dhe shoqata biznesi.

Koha në kufi dhe tarifat e larta (p.sh. tarifa e

²⁷ World Bank (2019). Working Paper

²⁸ Banka Botërore (2018) “Albania MSME Finance for Growth Assessment”

²⁹ GIZ (2019). Programi për “Zhvillim të qëndrueshëm në zonat rurale të Shqipërisë”

skanimit) përbëjnë një problem real. Kalimi i kufirit është përkeqësuar nga mungesa e lidhjes midis kufijve dhe miratimi i pakët i qasjes së menaxhimit të rrezikut³⁰. Disa stimuj janë në vend, por ato shpesh janë ose shumë të ngushta ose specifike. Për sa i përket promovimit dhe mbështetjes së eksportit, kompanitë raportojnë prani të dobët të qeverisë³¹. Masat jo-tarifore përbëjnë pengesën kryesore për tregtinë.³² Proceset e certifikimit të cilësisë së Shqipërisë janë të pamjaftueshme për eksport në BE-28, si dhe zakonisht shumë të kushtueshme për pronarët e vegjël³³. Kompanitë raportojnë një mungesë të përgjithshme të vetëdijes për rëndësinë e certifikimit midis prodhuesve dhe fermerëve. Nuk ka njohje reciproke të certifikimeve midis vendeve të CEFTA, nuk ka laboratorë në Shqipëri për të marrë certifikim ndërkombëtar (nuk ka laboratorë të akredituar në Shqipëri), dhe kostot (si për sa i përket tarifave dhe dokumenteve) për të aplikuar për certifikim raportohen të jenë të larta.

Vlen të përmendet se krahasimi me shtyllat e tjera, si çështjet ligjore, administrative dhe institucionale, përfshirë edhe TVSH-në nuk janë theksuar specifikisht nga bizneset gjatë intervistave tona si pengesa për sektorin. Këtu më poshtë janë përmbledhur përgjigjet e dhëna.

Gjetjet kryesore nga Anketa e Sekretariatit dhe intervistat ballë për ballë me 42 kompani që operojnë në agro-përpunim:

30 World Bank (2019). Albania Growth and Jobs: Policy Implementation Support Policy Note on Strengthening Albania's Trade Competitiveness

31 Idem.

32 Idem

33 World Bank (2018). Competitive Fruit and Vegetable Products in Albania. Finance, Competitiveness and Innovation in Focus. World Bank Group, Washington DC

Komente konkrete nga kompanitë e intervistuar:

- » Aksesit në informacion për marrjen e një certifikate është shumë i vështirë dhe nevojiten trajnime
- » Skanimi në dogana ka rritur kostot; nuk ka laboratorë të akredituar - Analizat ISUV nuk janë të përshtatshme për eksport në shumë vende (veçanërisht në BE)
- » Inspektimet dhe bar-kodet e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit nuk zbatohen për eksportuesit
- » Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka nevojë për përmirësim të procedurave dhe dokumentacionit
- » Sistemi bankar operon me ritme të larta për bujqësinë krahasuar me rajonin
- » Mosfunksionimi i Shoqatave të Bashkëpunimit Bujqësor
- » Probleme me certifikatën fitosanitare për eksportet nga Kosova dhe Serbia (tranzit)

Kufizimet kryesore për kryerjen e investimeve të reja sipas kompanive të intervistuar

- » Institucionet nuk janë mbështetëse dhe nuk stimulojnë investimet e biznesit
- » Tokë, leje ndërtimi në tokë bujqësore, procedurat dhe stabiliteti i furnizimit dhe cilësisë së lëndëve të para
- » Aksesit në financim (kryesisht për fermerët) - rritja e mbështetjes së granteve nga shteti dhe donatorët dhe ulja e normave të interesit nga sistemi bankar
- » Mungesa e orientimeve nga institucionet shtetërore në tregje të reja dhe pjesëmarrje dinjitoze në panaire ndërkombëtare

Sekretariati i KI analizoi çështjet e mëposhtme të biznesit të cilat kanë qenë më të shpeshta në të kaluarën dhe kanë një natyrë sistematike:

[1] Marrja e certifikatave fitosanitare

Sipas legjislacionit shqiptar inspektimi fitosanitar zbatohet për dërgesat hyrëse dhe dalëse të ushqimeve, bimëve dhe produkteve bimore, të cilat duhet të shoqërohen nga certifikata fitosanitare si kërkesa kryesore ligjore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për certifikimin e produkteve³⁴. Certifikata fitosanitare bazohet në modelin e Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve (IPPC) dhe lëshohet nga AKU/(nga 2018 nga Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve) pas inspektimit. Inspektimi kryhet në terminal ose në magazinat e bizneseve dhe duhet të ndodhë jo më herët se 14 ditë para datës së dërgimit të dërgesës për zhdoganim dhe certifikata duhet të nënshkruhet brenda periudhës 14-ditore³⁵. Bizneset e intervistuar deklaruan se nuk kanë hasur asnjë vështirësi për marrjen e certifikatave fitosanitare në nivel kombëtar, zakonisht të marra brenda disa orësh nga njoftimi tek autoritetet. Sidoqoftë, në disa raste certifikatat kombëtare fitosanitare nuk janë pranuar nga autoritetet e vendit importues, ndërsa kërkojnë certifikime dhe analiza shtesë në lidhje me produktet bimore (d.m.th. niveli i pesticideve të përdorura). Ka pasur zhvillime pozitive në lidhje me bashkëpunimin, veçanërisht midis vendeve në rajon për njohjen reciproke të certifikatave fitosanitare dhe heqjen e barrierave jo-tarifore që pengojnë qarkullimin e lirë të mallrave. Për shembull, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë rënë dakord të pranojnë certifikatat e ndërsjella fitosanitare për eksportet bujqësore³⁶. Gjithashtu janë bërë

përpjekje në kuadrin e bashkëpunimit rajonal nga vendet e CEFTA-s, të cilat në shkurt të vitit 2020, kanë rënë dakord me vendim për të lehtësuar dhe shpejtuar tregtinë e perimeve dhe frutave ndërmjet palëve të CEFTA-s, duke përfshirë njohjen reciproke të certifikatave³⁷. Vendimi do të thjeshtojë sistemin e kontroleve për tregtinë e frutave dhe perimeve brenda rajonit të CEFTA-s dhe do të shkurtojë kohën e kontrollit në kufi, që do të thotë që prodhuesit do të jenë në gjendje të dorëzojnë produktet e tyre te përdoruesit e fundit shumë më shpejt. Çdo palë e CEFTA-s është angazhuar për të krijuar një regjistër të tregtarëve të certifikuar të frutave dhe perimeve dhe do të ketë gjithashtu një listë të përbashkët të CEFTA-s për ato produkte që kanë nevojë për certifikata të detyrueshme fitosanitare³⁸.

[2] Miratimi i legjislacionit që mbështet produktin vendas "Made in Albania" ka sjellë bujqësinë në qendër të diskutimeve midis komunitetit të biznesit dhe qeverisë. Sidoqoftë kërkojnë përpjekje të mëtejshme për të rritur promovimin e sektorit dhe zbatimin e një legjislacioni të tillë.

- (1) Rritje e mëtejshme e stimujve fiskalë dhe programeve mbështetëse për bujqësinë dhe agro-përpunimin edhe pse ka patur një trend në rritje në futjen e këtyre skemave. Sidoqoftë, duke marrë parasysh kërkesën për mbështetje nga operatorët e biznesit dhe ndikimin e bujqësisë për ekonominë e vendit, mund të argumentohet për një mbështetje shtesë të mëtejshme dhe të konsiderueshme. Një listë e stimujve dhe programeve mbështetëse janë renditur në Shtojcën 8.
- (2) Sa i përket politikave për cilësinë, Ligji për Skemat e Cilësisë së Produkteve Bujqësore dhe

34 Ka disa ligje të zbatueshme në këtë rast: Ligji nr. 9362 "Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve", Ligji nr. 9863 "Për Ushqimin", Ligji nr. 10433 "Për Inspektimin".

35 UNECE - "Kufizimet Rregullatore dhe Procedurale të Tregëtisë në Shqipëri" (2016).

36 <https://bujqesia.gov.al/shengeni-ballkanik-shqiperia-dhe-maqedonia-e-veriut-nenshkruajne-marreveshjen-per>

shkembimin-tregtar-te-produkteve-bujqesore/

37 Komiteti i Përbashkët i CEFTA miratoi Vendimin për Lehtësimin e Tregëtisë për Frutat dhe Perimet më 25.02.2020 në Malin e Zi.

38 <https://cefta.int/news/cefta-to-facilitate-trade-in-fruit-and-vegetables>

Ushqimore u miratua në shkurt 2019³⁹. Ai krijon skema cilësore dhe organe përgjegjëse për njohjen dhe vmbrojtjen e emërtimeve të origjinës, treguesve gjeografikë dhe specialiteteve tradicionale të garantuara për produktet bujqësore dhe ushqimet.

- (3) *Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës.* Treguesi Gjeografik (TGJ) është një shenjë e përdorur në produktet që kanë një origjinë specifike gjeografike dhe kanë cilësinë ose reputacionin që vijnë nga ajo origjinë. Në mënyrë që të funksionojë si një TGJ, një shenjë duhet të identifikojë një produkt si me origjinë nga një vend i caktuar. Për më tepër, cilësitë, karakteristikat ose reputacioni i produktit duhet të vijnë kryesisht nga vendi i origjinës. Meqenëse cilësitë varen nga vendi gjeografik i prodhimit, ekziston një lidhje e qartë midis produktit dhe vendit origjinal të tij të prodhimit. E drejta mbi treguesin gjeografik u mundëson atyre që kanë të drejtë të përdorin treguesin për të parandaluar përdorimin e tij nga një palë e tretë produkti i së cilës nuk përputhet me standardet e zbatueshme. Sidoqoftë, një tregues i mbrojtur gjeografik nuk i lejon zotëruesit të parandalojë dikë nga prodhimi i një produkti duke përdorur të njëjtat teknika si ato të përcaktuara në standardet për atë tregues. Mbrojtja për një tregues gjeografik zakonisht merret duke fituar një të drejtë mbi shenjën që përbën treguesin. Treguesit gjeografikë përdoren zakonisht për produktet bujqësore, produktet ushqimore, verën dhe pijet alkoolike, artizanatin dhe produktet industriale. Shqipëria që nga viti 2017 ka miratuar në legjislacionin e saj aktual rregulla të reja për mbrojtjen dhe regjistrimin e treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës të cilat mundësojnë regjistrimin⁴⁰.

39 Ligji nr. 18/2019

40 Ndryshimet në ligjin nr. 9947 datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale" hynë në fuqi me Ligjin nr. 17/2017 në pjesën V të tij.

Sipas këtyre rregullave, çdo person ose grup personash fizikë ose juridikë që prodhon, përpunon ose përgatit, në një zonë të caktuar gjeografike, një produkt për përcaktimin e të cilit përdoret një tregues gjeografik, ka të drejtë të paraqesë një kërkesë për regjistrimin e këtij treguesi. Në përputhje me këto rregulla, Qeveria e Shqipërisë ka miratuar një rregullore të re që synon të mbështesë praktikën më të mira.⁴¹ Që prej shtatori 2020, nën regjistrin përkatës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, rezultojnë 24 aplikime për tregues gjeografikë, nga të cilët 20 tregues si Uji Glina, Gështenja Tropojës, Jufka Dibrane, etj. janë dorëzuar nga prodhuesit shqiptarë.

- (4) *Bujqësia organike*⁴². Ligji "Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve Bio" (2004)⁴³ krijoi kornizën ligjore dhe përcaktimin e kushteve të prodhimit, përpunimit, transportit, certifikimit dhe kontrollit të produkteve bujqësore dhe ushqimore me origjinë bimë ose shtazore, të cilat prodhohen, përpunohen dhe/ose importohen dhe tregtohen si produkte "Bio". Në vijim, me qëllim të përafrimit me *acquis communautaire*, u miratua ligji nr. 106/2016 "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre" me të cilin u shfuqizua ligji i vitit 2004⁴⁴.

Një listë e licencave dhe procedurave që duhet të ndiqen për licencim janë të detajuara në Shtojcën 14 dhe 15 ndërsa një udhëzues për procedurat e investimeve në agro-përpunim jepet nga AIDA dhe përfshihet këtu në Shtojcën 16.

41 VKM nr. 251, datë 24.4.2019

42 <https://bujqesia.gov.al/prodhim-bio/>

43 Ligji nr. 9199/2004

44 Ligji 106/2016 zëvendësoi ligjin 9199/2004 duke e shfuqizuar atë dhe duke u përafruar pjesërisht me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 834/2007, datë 28 qershor 2007, "Për prodhimin biologjik dhe etiketimin e produkteve biologjike dhe që shfuqizon Rregulloren (KEE) 2092/91", të ndryshuar.

GJETJET KRYESORE PËR PRODUKTET E PËRZGJEDHURA

1. DOMATET

Tendencat e prodhimit dhe përpunimit

Prodhi i domates është rritur ndjeshëm gjatë dhjetë viteve të fundit, duke u bërë produkti më i rëndësishëm nga perimet si përsa i përket sipërfaqes së kultivuar ashtu dhe prodhimit to-

tal të perimeve. Në 2019 domatja zinte rreth 24% të sipërfaqes totale të kultivuar me perime dhe siguronte rreth 36% të totalit të prodhimit të perimeve. Rreth 51% e prodhimit total të domates sigurohet nga prodhimi në serra, duke zënë rreth 56% të totalit të prodhimit të perimeve në serra.


Tabela 1. Vendi i prodhimit të domates në totalin e prodhimit të perimeve në Shqipëri

	Sipërfaqja totale (ha)		Sipërfaqja ne serra (ha)		Prodhi total (ton)		Prodhi në serra (ton)	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Total perime	25 854	27 458	3 080	3 239	771 724	832 732	248 816	264 085
Total domate	6 587	6 663	1 603	1 670	288 626	299 669	139 857	148 249
Domate/Perime total (%)	25%	24%	52%	52%	37%	36%	56%	56%

Burimi: MBZHR

Sipas INSTAT (2019), **sektori i serrave dominohet nga serrat pa ngrohje (diellore, shumica të mbuluara me plastik), me investime dhe kosto operative të ulta krahasuar me serrat me ngrohje**. Shumica e serrave janë të mbuluar me plastik dhe vetëm rreth 5% e sipërfaqes totale të serrave janë me ngrohje. Ka dy arsye kryesore për dominimin e serrave pa ngrohje: (i) kushtet e favorshme klimatike;

Figura 27. Prodhimi i perimeve të përpunuara/konservuara gjatë 2015-2019 (milione ALL)




Burimi: MBZHR

Përpunimi i domates është i kufizuar dhe luhatjet e tij reflektojnë paqëndrueshmërinë dhe papërshtatshmërinë e furnizimit me lëndë të para për agropërpunimin. Bazuar në të dhënat e MBZHR industria e prodhimit të perimeve dhe frutave të konservuara përfaqësohet nga rreth 29 kompani (rreth 1,2% e numrit total të sektorit të agro-përpunimit). Produktet kryesore të prodhuara përfshijnë perimet e konservuara (kastravec, speci), salcë domatesh dhe domate të thata. Prodhimi i perimeve të përpunuara pësoi një rënie të ndjeshëm në 2016 dhe më pas ka një rritje të vogël në vitet e tjera. Megjithatë, luhatjet e tij

dhe (ii) kostot e larta të karburantit për ngrohje. Shumica e serrave janë të vogla, të menaxhuara nga fermerë të vegjël me burime financimi të pakta, të cilët preferojnë të zgjedhim alternative me investime të ulta (në këtë rast serrat plastike pa ngrohje).⁴⁵

⁴⁵ Skreli, E. & Imami, D. (2019). Greenhouse vegetable sector in Albania. AASF.

Figura 28. Prodhimi i salcës së domates gjatë 2015-2019 (milione ALL)



reflektojnë paqëndrueshmërinë e furnizimit me cilësitë dhe çmimet e përshtatshme të lëndëve të para. Furnizimi aktual me lëndë të para nga fermat është i papërshtatshëm për agro-përpunimin për dy arsye kryesore: (i) papërshtatshmëria e kultivarëve të domates për të plotësuar kërkesat e përpunimit; dhe (ii) sasia e vogël e domateve të disponueshme me çmime mjaftueshmërisht të ulta për të qënë konkurruese për përpunimin. Struktura aktuale e prodhimit të domates (sa i përket madhësisë së fermës, varieteteve të domates, kostove dhe çmimeve) është e orientuar kryesisht drejt tregut të domateve të freskëta.

Tregu

Eksportet e domateve të freskëta janë rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit, duke e bërë Shqipërinë një aktor të rëndësishëm rajonal/ndërkombëtar, veçanërisht nga prodhimi në serra. Domatet e freskëta përfaqësojnë rreth 11% të totalit të eksporteve agro-ushqimore. Eksportet e domateve të freskëta janë rritur dukshëm (pothuajse 10 herë që nga 2010) dhe kanë patur një kërkesë thuajse stabil ndërkombëtare. Baza kryesore e kësaj rritjeje të shpejtë lidhet kryesisht me rritjen e shpejtë të sipërfaqeve me serra përmes investimeve private.

Ashtu si për perimet e tjera, shumica e eksporteve të domateve të freskëta ndodhin në vendet me fuqi paguese të ulët, si pasojë, çmimet e eksporteve të domates së freskët mbeten disi të ulta. Shumica e domateve eksportohen në vendet e Ballkanit Perëndimor (si Kosova, Serbia,

Bullgaria dhe Bosnja & Herzegovina) ose në vendet e reja anëtare të BE-së (si Rumania dhe Bullgaria), të cilat kanë fuqi blerëse të ulët krahasuar me vendet e BE-15. Një nga arsyet është se produktet nuk janë të standardizuara siç duhet dhe rrallëherë të certifikuara. Edhe pse certifikimet Global G.A.P kanë filluar të rriten gjatë viteve të fundit, sipërfaqja totale e prodhimit të certifikuar mbetet akoma e kufizuar. Gjithashtu, zinxhirët e vlerës nuk janë të organizuar mirë, dhe shpeshherë të bazuar në tregje të rastësishme⁴⁶. Nga ana tjetër, ka mundësi të ketë raportime më të vogla (në dogana) duke marrë parasysh informalitetin që karakterizon Shqipërinë dhe shumë prej vendeve të destinacionit të këtyre eksporteve⁴⁷.

⁴⁶ GIZ (2019). Programi për "Zhvillim të qëndrueshëm në zonat rurale të Shqipërisë".
⁴⁷ Skreli, E. & Imami, D. (2019). Greenhouse vegetable sector in Albania. AASF.

Tabela 2. Vlera e eksporteve dhe importeve të domates së freskët (milione ALL)

	2015	2016	2017	2018	2019
Vlera e importeve	231	225	182	273	197
Vlera e eksporteve	2 830	3 299	4 228	4 439	4 033
Balanca (EXP - IMP)	2 599	3 074	4 045	4 166	3 836

Burimi: DPD

Tabela 3. Balanca e furnizimit me domate të freskët

	2015	2016	2017	2018	2019
Prodhimi (ton)	256 540	284 632	286 909	288 626	299 669
Importet (ton)	2 996	3 002	2 307	3 848	2 743
Eksportet (ton)	57 929	65 800	72 641	74 898	78 107
Furnizimi (ton)	201 608	221 834	216 576	217 575	224 305
Import/Furnizim (%)	1,5%	1,4%	1,1%	1,8%	1,2%
Eksport/Prodhim (%)	22,6%	29,7%	33,5%	34,4%	34,8%

Burimi: MBZHR, DPD

Sipas studimit të AASF, tregu vendas është i dominuar nga prodhimi lokal – pjesa e importeve në furnizimin total vendas (që është një llogaritje e përafërt e konsumit dhe llogaritet duke shtuar importet dhe zbritur eksportet nga prodhimi vendas) është modest, përkatësisht më pak se 2%. Ndonëse tregu vendas mbetet tregu kryesor për prodhimin vendas, pjesa e prodhimit të domates së freskët që shkon në

eksport është rritur dukshëm, nga 22,6% në 2015 në rreth 34,8% në 2019. Përsa i përket përpunimit të domates, balanca tregtare është shumë negative. Ashtu si domatja e freskët, shumica e domateve të përpunuara shiten në vendet e Ballkanit Perëndor dhe në vendet e reja anëtare të BE-së, ndërsa sasi të akoma shumë të vogla të domates së thatë të prodhuara në Shqipëri shkojnë pothuajse të gjitha drejt Italisë.

Tabela 4. Vlera e eksporteve dhe importeve të salcës së domates (milione ALL)

	2015	2016	2017	2018	2019
Vlera e importeve	116	130	137	161	162
Vlera e eksporteve	1	6	5	2	4
Balanca (EXP - IMP)	(115)	(124)	(132)	(160)	(158)

Burimi: DPD

Tabela 5. Bilanci i furnizimit me salcë domate (milione ALL)

	2015	2016	2017	2018	2019
Vlera e prodhimit (mln ALL)	34	7	7	8	9
Vlera e importeve (mln ALL)	116	130	137	161	162
Vlera e eksporteve (mln ALL)	1	6	5	2	4
Vlera e furnizimit (mln ALL)	149	131	139	168	167
Import/Furnizim (%)	78,2%	99,7%	98,8%	96,1%	96,9%
Eksport/Prodhim (%)	3,5%	4,9%	3,9%	0,9%	2,3%

Burimi: MBZHR, DPD

2. ARRORËT

Tendencat e prodhimit dhe përpunimit


Arrorët (veçanërisht gështenja) përbëjnë një burim të rëndësishëm të të ardhurave për komunitetet e zonave të thella malore të Shqipërisë, ku bujqësia intensive nuk është e mundur. Gështenja është produkti më i rëndësishëm nga arrorët, si në terma prodhimi ashtu edhe tregtie ndërkombëtare. Prodhimi i gështenjës bazohet kryesisht në masivët pyjorë, shumica e të cilëve

janë *de facto* organikë ndërsa disa prej tyre janë tashmë të certifikuar organikë, që përfaqësojnë një potencial të mirë për eksport⁴⁸. Prodhimi total i gështenjës është ulur lehtësisht nga 6.600 ton në 2015 në rreth 5.846 ton në 2019. Zonat më të rëndësishme të prodhimit të gështenjës gjenden në zonën e Tropojës (masivi krye-

48 Skreli, E. Imami, D. 2019. Chestnuts Sector Study. Albania Agribusiness Support Facility (AASF).

sor i prodhimit të gështenjës, me një masiv prej rreth 2.000 ha), ndjekur nga Malësia e Madhe, Dibra, Puka, Shkodra, Bulqiza, Librazhdi dhe Mati. Në shumicën e këtyre masivëve, prodhimi dhe produktiviteti po ndikohen negativisht nga numri i madh i pemëve të vjetra si edhe nga sëmundjet.

Figura 29. Sipërfaqja dhe prodhimi i gështenjës dhe arrës në 2019



Burimi: INSTAT, MBZHR

Industria e përpunimit të gështenjës në Shqipëri mbetet akoma shumë e kufizuar, ku vetëm pak prej kompanive prodhojnë disa sasi të kufizuara, përfshirë kryesisht: (i) ndarjen e gështenjave sipas madhësisë, larjen, tharjen, paketimin në thasë të vegjël, dhe vetëm në pak raste (ii) heqjen e lëvozhgës me të nxehtë dhe largimin me dorë të shtresës së brendshme.

Prodhimi i arrave gjendet kryesisht në sipërfaqet e pyjeve dhe ndonjëherë të kultivuara në parcela të vogla. Në sipërfaqet e tokave publike, arrat janë në copëza pyjesh të vegjël dhe në tokat e fermave të vogla, kryesisht në fomën e pemëve të mbjella në plantacione të vogla ose si pemë të

shpërndara kryesisht në bordurat e parcelave. Sipërfaqja totale me arra në 2019 ishte afërsisht 1.730 ha, nga vetëm 573 ha që ishin në prodhim të plotë. Në 2019, Shqipëria prodhoi një total prej rreth 6,199 ton arra⁴⁹.

Sa i përket prodhimit të lajthive dhe bajames në Shqipëri ka statistika të kufizuara. Përmishte me sipërfaqe të kufizuara të lajthive gjenden në zonën e Fierit, Korçës, Gjirokastrës dhe Pogradecit, kryesisht në tokat private të fermerëve të vegjël. Në disa raste lajthitë gjenden dhe si pjesë të pemishteve të përziera dhe si pemë të shpërndara në kufijtë midis parcelave të fermave. Ka edhe lajthi që rriten të egra të shpërndara në të gjithë vendin. Prodhimi i bajameve është i kufizuar dhe në pemishte të vogla në rrethet Mallakastër, Fier, Përmet, Tepelenë, Durrës dhe Vlorë.

Tregu

Eksporti total i gështenjave në vitin 2019 ishte 2.157 ton (që përfaqëson rreth 343 milionë ALL, ose rreth 1% të eksporteve të sektorit të bujqësisë) duke shënuar rreth 39% ulje krahasuar me 3.561 ton në 2015 (që përfaqësojnë rreth 646 milionë ALL, ose rreth 4,2% të eksporteve të sektorit të bujqësisë). Eksportet e gështenjave janë rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Shumica e eksporteve shkojnë në Itali si produkt lëndë e parë organike për industrinë e përpunimit, ndërsa disa sasi të vogla shiten në Kosovë, Serbi dhe Maqedoni. Çmimi i marrë për gështenjat shqiptare është ndër më të ultët në botë, kryesisht për shkak të mungesës së standardit të produktit dhe proceseve të dobëta të pasvëljës. Eksportet e produkteve të arrorëve të tjerë (arra, lajthi dhe bajame) janë shumë të vogla dhe të çrregullta.

49 INSTAT

Tabela 6. Vlera e eksporteve dhe importeve të gështenjës (milionë ALL)

	2015	2016	2017	2018	2019
Importet (ton)	181	196	234	272	327
Importet (milionë ALL)	11	13	14	17	22
Eksportet (ton)	3 561	5 859	2 712	1 931	2 157
Eksportet (milionë ALL)	658	1 069	480	340	365
Balanca në vlerë (EXP - IMP)	646	1 056	466	323	343

Burimi: DPD



3. BIMËT MJEKËSORE DHE AROMATIKE

Tendencat e prodhimit dhe përpunimit

Shqipëria ka një traditë të hershme në prodhimin dhe eksportimin e BMA-ve. Edhe pse sasi të konsiderueshme të BMA-ve të egra vazhdojnë të mbledhen nga pyjet, kultivimi i BMA-ve ka marrë rëndësi të veçantë në vitet e fundit. Prodhimi i përgjithshëm i BMA-ve të kultivuara është rritur me rreth 20% në pesë vitet e fundit, duke arritur rreth 12.922 ton në 2019 (krahasuar me 10.760 ton në 2015). Rreth 90% e fermerëve që kultivojnë

BMA gjenden në rajonin e Shkodrës (kryesisht në Malësi të Madhe). Bimët kryesore të kultivuara janë sherebela, livanda dhe trumza. Sipas studimit të AASF⁵⁰, ka rreth 20 përpunues të vegjël që kryejnë përpunim të thjeshtë (me një kapacitet përpunimi që varion nga 150 deri në 500 MT në vit) dhe rreth 8-20 përpunues/eksportues të mesëm deri në të mëdhenj (me një kapacitet përpunimi që varion midis 500 MT dhe 2.400 MT çdo vit).

50 Skreli, E. Imami, D. 2019. Medical and Aromatical Plants Sector Study. Albania Agribusiness Support Facility (AASF).

Figura 31. Rritja/ulja vjetore e sipërfaqeve dhe prodhimit të BMA-ve të kultivuara (në %)**Figura 30. Sipërfaqja dhe prodhimi i BMA-ve të kultivuara (në ton)**

Burimi: INSTAT, MZHBR

Tregu

Më shumë se 95% e totalit të BMA-ve që mbledhen dhe kultivohen në vend eksportohen, duke e bërë Shqipërinë një aktor të rëndësishëm ndërkombëtar në këtë sektor. Shqipëria është një furnizues i rëndësishëm i lëndëve të para ose produkteve gjysëm të gatshme për shumë industri të BE-së dhe SHBA-së në sektorë të ndryshëm (industria e ushqimit dhe pijeve, kujdesi shëndetësor, kozmetikë dhe parfume, aditivë, etj.)—gati

34 e sherebelës së importuar nga SHBA vjen nga Shqipëria. Rritja e eksportit ka ardhur si pasojë e një kombinimi të ofertës në rritje (kryesisht përmes rritjes së BMA-ve të kultivuara) dhe rritjes së kërkesës në tregun botëror. Nga ana tjetër, rritja e eksporteve dhe oferta në rritje shoqërohet me disa sfida në lidhje me organizimin dhe koordinimin midis dhe ndërmjet aktorëve. Gjithashtu, duhet të theksohet se nga intervistat evidentohet një rritje e tregut farmaceutik për esencat.

Tabela 7. Vlera e eksporteve dhe importeve të BMA-ve (milion ALL)

	2015	2016	2017	2018	2019
Importet (ton)	205	102	194	193	204
Importet (milionë ALL)	58	41	52	72	59
Eksportet (ton)	12 457	12 789	11 875	12 261	11 715
Eksportet (milionë ALL)	3 709	3 646	3 242	3 800	4 107
Balanca në vlerë (EXP - IMP)	3 650	3 605	3 190	3 728	4 048

Burimi: DPD

Tabela 8. Eksportet e vajrave esencialë (milionë ALL)

	2015	2016	2017	2018	2019
Vlera e Eksporteve (ALL)	34 477	48 319	53 966	275 812	595 096

Burimi: Shoqata e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike


4. LËNGJET E FRUTAVE

Tendencat e prodhimit dhe përpunimit

Zinxhiri i vlerës së frutave është zhvilluar ndjeshëm në vitet e fundit, duke zënë rreth 22% të prodhimit të përgjithshëm bujqësor⁵¹. Gjatë dekadës së fundit, prodhimi i frutave ka dëshmuar një rritje të ndjeshme të rendi-

menteve dhe sipërfaqeve të mbjella me pemë frutore. Skemat e ndryshme mbështetëse nga Qeveria Shqiptare, IPARD dhe agjencitë e tjera donatore, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në stimulimin e zgjerimit të nën-sektorit të frutave, përmes mbështetjes për mbjelljen e pemëtoreve të reja, investimeve në puse dhe sisteme ujitje, sisteme të mbrojtjes së bimëve, fidanëve të varieteteve indigjene, etj.

51 GIZ (2019). Programi për "Zhvillim të qëndrueshëm në zonat rurale të Shqipërisë".

Figura 32. Prodhimi i pemëve frutore dhe agrumeve në 2018 dhe 2019 (në ton)


Burimi: MBZHR (2020)

Prodhimi i lëngjeve të frutave në Shqipëri është mjaft i pazhvilluar dhe nuk ka statistika të disponueshme për totalin e lëngjeve të frutave të prodhuar në vend. Ka vetëm dy kompani që prodhojnë lëng frutash me fruta të prodhuara në vend, kryesisht nga mollët (një në Korçë dhe një në Dibër), ndërsa ndërmarrjet e tjera prodhojnë lëngje frutash duke përdorur kryesisht koncentrat frutash të importuar. Megjithatë, ka luhajtje të forta në prodhimin e lëngjeve të frutave nga viti në vit për shkak të luhatjeve në disponueshmërinë e lëndëve të para dhe teknologjitë e përpunimit.

Tabela 9. Vlera e eksporteve të lëngjeve të frutave (milionë ALL)

	2015	2016	2017	2018	2019
Importet (ton)	2 569	2 285	2 876	2 721	2 995
Importet (milionë ALL)	295	286	364	324	306
Eksportet (ton)	106	123	18	4	94
Eksportet (milionë ALL)	11	11	2	1	8
Balanca në vlerë (EXP - IMP)	(285)	(275)	(363)	(323)	(299)

Burimi: DPD

Figura 33. Rritja/zvogëlimi vjetor i sipërfaqes dhe prodhim-it të pemëve frutore dhe agrumeve (2019/2018, në %)

Tregu

Bilanci tregtar i lëngjeve të frutave është shumë negativ, ku importet janë rreth 38 herë më të larta se eksportet në 2019. Eksportet totale të lëngjeve të frutave kanë rënë nga 123 ton në 2016 në vetëm rreth 94 ton në 2019. Për më tepër, gjatë pesë viteve të fundit, Shqipëria ka importuar midis 175 dhe 260 ton koncentrat frutash në vit, i cili përdoret nga industria përpunuese e prodhimit të frutave dhe që potencialisht mund të zëvendësohet me prodhimin vendas.

Tabela 10. Vlera e eksporteve të lëngjeve të koncentratit të frutave (milionë ALL)

	2015	2016	2017	2018	2019
Importet (ton)	256	257	248	176	232
Importet (milionë ALL)	69	95	107	80	65
Eksportet (ton)	1	-	-	-	1
Eksportet (milionë ALL)	0	-	-	-	0
Balanca në vlerë (EXP - IMP)	(68)	(95)	(107)	(80)	(64)

Burimi: DPD

5. POTENCIAL I INVESTIMEVE⁵² – DOMATJA, ARRORET, FRUTAT Domatja

Produktet e përpunuara të domates që kanë potencial më të lartë në tregun e eksportit janë domatet e thata, salca dhe lëngjet e domates. Sidoqoftë, pengesa kryesore për zhvillimin e industrisë së përpunimit të domates është furnizimi i kufizuar (në sasi dhe cilësi) me lëndë të parë të përshtatshme për industrinë e përpunimit. Zhvillimi i një furnizimi të tillë të përshtatshëm do të kërkonte:

- » futja e kultivarëve të domates të përshtatshëm për përpunim (të cilat mund të kultivohen edhe në fusha të hapura);
- » prodhim në shkallë të gjerë në ferma të mëdha dhe me mekanizëm (në mënyrë që të prodhohen sasi të mjaftueshme të mëdha dhe me kosto të ulët);
- » Investime nga industria e qelqit për të prodhuar paketimin e produktit të salcës, pasi paketimi përbën rreth 40% të koston së prodhimit dhe në të njëjtën kohë ka mundësi të larta për eksport.

⁵² Vlerat e investimeve (kosto, vlera e lëndës së parë, kërkesa e tregut, etj.) në këtë seksion janë llogaritje të eksperteve që Sekretariati angazhoi për këtë studim.

Kërkesa e brendshme për salcë domate është e lartë, por ka vështirësi në sigurimin e lëndëve të para të përshtatshme. Nevojiten të mbillen përafërsisht 70-80 ha domate për salcë për të mbuluar nevojat e konsumit vendas. Duke marrë parasysh se kërkesa për eksport është 3 herë më e lartë se konsumi vendas, atëherë për të prodhuar sasinë e nevojshme të salcës nevojitet të mbillen rreth 200-250 ha kultivim të domates për salcë. Bazuar në Kartën Teknologjike, kostoja për prodhimin e 1 ha domate për salcë është rreth 8.000 euro/ha. Pra, kërkohet një investim prej 560.000 euro për të siguruar lëndën e parë të nevojshme për të përmblusur kërkesën e tregut të brendshëm dhe 1,6 milionë euro për tregun e eksportit.

Bimët mjekësore dhe aromatike

Eksportet e esencave të bimëve mjeksore konsiderohen si potencial për hir të kërkesës së tregut të jashtëm, por kërkohet një harmonizim i lidhjeve ndërvepruese në zinxhirin e vlerës në BMA-ve. Plotësimi i kërkesës së tregut mund të kërkojë një investim në distileri në shumën prej rreth 6 milionë euro⁵³, shoqëruar me investime në ferma në një sipërfaqe prej rreth 11.000 ha me një vlerë prej afërsisht 50 milionë euro.

⁵³ Ref karta teknologjike në shtojca

Gështenja

Kërkesa e tregut vendas dhe ndërkombëtar për gështenjë është shumë e lartë, pasi ky produkt mund të përdoret si produkt i freskët por edhe në industrinë e përpunimit. Përafërsisht 3.500 ha gështenja kërkohen të kultivohen për të siguruar konsumin e brendshëm dhe kërkesën për eksport. Bazuar në Kartën Teknike, kostoja për prodhimin e 1 ha gështenja është rreth 8.000 euro/ha. Bazuar në të dhënat statistikore në Shqipëri ka rreth 2.500 ha me gështenja. Pra, kërkohet një investim prej 8 milionë euro për të rritur 1.000 ha me gështenja për të siguruar prodhimin e lëndëve të para për të përmbushur

kërkesën e tregut të brendshëm dhe tregut të eksportit.

Lëngje frutash

Kërkesa vendase për lëngje të freskëta frutash është relativisht e lartë (importohen rreth 3 milionë litra, me përjashtim të koncentratit). Ky projekt investimi kërkon mbështetje në prodhimin e lëndës së parë, pra mbjelljen e rreth 1.000-1.200 ha frutore (kryesisht portokall), me një kosto prej rreth 7-8 milionë euro. Në mënyrë që kjo industri prodhuese të jetë konkurruese në tregjet ndërkombëtare, kërkon investime nga industria e qelqit, duke qënë se paketimi përbën rreth 40% të koston së prodhimit.

REKOMANDIME

Rekomandimet e mëposhtme janë rezultat i analizës dhe konsultimeve të Sekretariatit të KI me aktorë dhe ekspertë si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Rekomandimet e dhëna këtu nuk parashikojnë zgjidhje shpëruese për problemet dhe çështjet me të cilat përballlet bujqësia dhe agro-përpunimi. Qëllimi i tyre është të sjellin nënsektorët në vëmendjen e vendimmarrësve, duke vendosur dhe rritur fokusin tek produktet vendase dhe markën “Made in Albania”. Qëllimi përfundimtar është (i) tërheqja e investitorëve në këto sektorë duke investuar në linjat e para-seleksionimit, dimensionimit, kurimit, pastrimit, seleksionimit, paketimit dhe etiketimit në mënyrë që të arrihet kontroll i rreptë i cilësisë dhe pajtueshmërisë me standardet (ndërkombëtare), (ii) asistimi i politikave bazuar në metodologjitë bashkëkohore me fokus në produktet/aktivitetet bujqësore me vlerë të lartë në tregjet ndërkombëtare. Për të mos krijuar përsëritje, nuk kemi përfshirë në këtë seksion rekomandime të tjera të miratuara në mbledhjet e mëparshme të KF⁴, disa prej të cilave mbeten ende koherente dhe të rëndësishme për sektorët e analizuar.

54 “Mbi Rimëkëmbjen Ekonomike Post Covid-19”, “Mbi Potencialet e Investimeve dhe Sektorët Prioritarë”, “Siguria Ligjore mbi Pronën”, “Aksesi në Financim në Bujqësi”, “Informaliteti në Ekonomi”, “Platforma Elektronike e Lejeve të Ndërtimit”.

BASHKËPUNIMI, INTEGRIMI I ZINXHIRIT TË VLERËS DHE FURNIZIMI ME LËNDË TË PARË

1. Në mënyrë që të incentivohet bashkëpunimi i fermerëve në katër sektorët kryesorë të lartpërmendur, rekomandohet të vendosen incentiva dhe skema mbështetëse të synuara për katër nën-sektorët, përmes:
 - » uljes së procedurave administrative dhe zbatimit të incentivave administrative për

regjistrimin e tokës dhe lejet e ndërtimit për anëtarët e kooperativës/organizata të fermerëve; padyshim duke ruajtur respektin e veçantë për të drejtat e pronës private;

- » zbatimit të incentivave fiskale për organizimet e fermerëve (d.m.th. taksa më të ulëta lokale/të pronës, etj.);
- » zbatimit të skemave të mbështetjes së kreditimit (d.m.th. skema të garancisë dhe norma preferenciale të interesit bankar për aplikimet për kredi nga kooperativa/organizime).

2. Nxitje/stimulim për rritjen e integritimit të zinxhirit të vlerës dhe furnizimit me lëndë të parë për agro-përpunimin në katër nënsektorët e zgjedhur, përmes:

- » **Bujqësi me kontratë dhe prodhimit në shkallë të gjerë:** (i) futja e skemave të reja mbështetëse (nga AZHBR) për stimulimin e bujqësisë me kontratë, veçanërisht për BMA dhe prodhimin e domates të destinuar për industrinë e përpunimit; (ii) rritje të skemave qeveritare të sigurimit për prodhimin e kontraktuar në shkallë të gjerë të BMA-ve, pemëve frutore (sidomos agrumeve) dhe domateve të destinuara për industrinë e përpunimit; **Sektori i bimëve mjekësore:** Zbatimi i incentiveve (administrative/procedurale, tarifa të favorshme të qirasë) për marrjen me qira të tokës publike (nga MBZHR dhe qeveria lokale) për kultivimin e bimëve mjekësore të destinuara për prodhimin e esencave (veçanërisht për produkte të tilla si dafina, elikrisium, dëllenja e e zeza, etj). Përveç kërkesës së lartë për eksporte të vajrave esenciale, kjo duhet të bëhet gjithashtu një shtysë për përdorimin e këtyre produkteve në sektorin farmaceutik shqiptar;
- » **Domatet** për industrinë e përpunimit. Zbatimi i skemave mbështetëse (nga AZHBR, d.m.th. një sasi të caktuar për hektar ose për ton të dorëzuar në fabrikë) duke stimuluar kultivimin e domateve në fushë të hapur të destinuara për industrinë e përpunimit, duke përdorur varietetet/kultivarët e duhur që janë të përshtatshëm për prodhimin e salcës. Ky gjithashtu shihet si një orientim më i mirë për fermerët për të diversifikuar prodhimin e fermave në fushë të hapur dhe për të rritur efikasitetin e përdorimit të tokës;
- » **Arrorët:** (a) Futja e skemave mbështetëse

(nga AZHBR) për rehabilitimin e pyjeve ekzistuese të gështenjave si dhe në mbrojtjen e tyre kundër sëmundjeve të cilat nuk mund të bëhen vetëm nga fermerë individualë; (b) rritje të mbështetjes për mbjelljen e pemishteve të reja të gështenjave dhe arrave përmes: (i) zbatimit të incentiveve (administrative/procedurale, tarifave të favorshme të qirasë) për marrjen me qira të tokës publike (nga MBZHR dhe qeveria lokale) për kultivimin e gështenjave dhe arroveve; (ii) investimeve (skemave mbështetëse nga AZHBR) në mbjelljen e pemishteve intensive të gështenjave dhe arroveve me kultivarë të zgjedhur/të cilësisë së lartë, (iii) investimeve (skemave mbështetëse nga AZHBR) në rritjen e standardit të fidanishteve për të prodhuar materiale mbjellëse me cilësi të lartë për varietetet e kërkuara në tregun e eksportit, e cila është një domosdoshmëri absolute për prodhimet shqiptare që hyjnë në tregun e eksportit; (iv) skema mbështetëse të kredisë (d.m.th. skema e garancisë dhe normat preferenciale të interesit bankar) për investime në plantacionin e gështenjave dhe arroveve, të cilat do të hynin në prodhim rreth 4 vite pas mbjelljes;

- » **Sektori i agrumeve.** Të rriten skemat e granteve (nga AZHBR) dhe skemat e mbështetjes së kredisë (d.m.th. skemat e garancisë dhe normat preferenciale të interesit bankar) për investime në mbjelljen e pemishteve të reja, veçanërisht me agrume për të përmbushur kërkesën e konsumit kombëtar dhe nevojën e industrisë përpunuese.

INFORMACIONI I TREGUT

3. Krijimi i një Njësie të Inteligjencës së Tregut (mundësisht brenda AIDA, AZHBR apo një institucioni tjetër, si p.sh. Universiteti Bujqësor)

sor) për të siguruar informacion të përditësuar mbi nevojat aktuale të tregut të brendshëm dhe të jashtëm për sa i përket produkteve në përdorim të freskët ose në industrinë e përpunimit.

4. Në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, shoqatat e biznesit, shoqatën e eksportit, Universitetin Bujqësor, etj., të organizohen takime/trajnime praktike duke informuar fermerët mbi:

- » trendet në fushën e bujqësisë dhe të përpunimit për investime potenciale sipas kërkesës së tregut për eksport;
- » cilat janë produktet që kërkohej nga tregu ndërkombëtar, për përdorim të freskët ose në industrinë e përpunimit duke synuar përditësimin në kohë të prodhimit aktual të të njëjtit lloj në një shkallë të gjerë.

CILËSIA DHE KONKURRENCA

5. Mbështetje për krijimin e një mjedisi mundësues për zhvillimin e eksporteve shqiptare në BE dhe në tregje të tjera me vlerë më të lartë, me masat e mëposhtme ndër-sektoriale:

- » Të mundësohet pranimi i certifikatës reciproke fitosanitare për eksportet e produkteve bujqësore në/nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, siç u arrit kohët e fundit me Maqedoninë e Veriut. Zbatimi në praktikë i bashkëpunimit rajonal, sinergji të reja për potenciale të reja të pashkelura për rajonin me qarkullim të lirë të mallrave, punëdhënësve, kapitaleve dhe heqje të shumicës së barrierave jo-tarifore. Për këtë qëllim, kërkohej zbatimi në praktikë i angazhimeve dhe procedurave të rena dakord nga vendet e CEFTA-përmes vendimit në shkurt 2020;

- » *Përshejtim të modernizimit dhe akreditimit të laboratorëve ekzistues dhe të rinj të testimit (analizat ISUV nuk janë të përshtatshme për eksport në shumë vende, veçanërisht në BE), mundësimi i këtyre për të lëshuar certifikatën e eksportit të njohur në tregjet e BE është gjithashtu një çështje me rëndësi. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për zinxhirët e vlerave të perimeve, frutave dhe BMA, pasi ato përbëjnë eksporte të mëdha;*
- » Mbështetja e politikave të integruara të promovimit që mundësojnë një kalendar të konsoliduar dhe transparent të panaireve ndërkombëtare, i cili potencialisht mund të sigurojë pjesëmarrje të denjë dhe qasje në kontrata dhe tregje të reja;
- » Investim në promovimin e produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, përmes organizimit të pjesëmarrjes sistematike dhe dinjitoze në panaire ndërkombëtare, fushata promovuese të cilësisë së lartë si dhe rritjen e përfshirjes së ambasadave tona në “diplomacinë ekonomike” duke promovuar “Made in Albania” dhe lehtësimin e lidhjeve midis kompanive shqiptare dhe të huaja.
- 6. **Përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe standardeve në përputhje me praktikën më të mirë**
 - » Sa i përket certifikimit organik, të mbështeten investimet drejt cilësisë së produktit dhe standardizimin përmes skemave mbështetëse për Global G.A.P., Organike, Certifikime Bio për perime, fruta dhe BMA, Fair Wild për BMA;
 - » Zbatimi i kontrollit mbi cilësinë dhe përdorimin e inputeve bujqësore (pesticide, herbicide dhe plehra) pasi ato ndikojnë drejt-përdrejtë në cilësinë/standartet e produktit përfundimtar;

7. **Të eksploroheh mundësitë për të stimuluar investitorët në fabrika për prodhimin e paketimit të qelqit brenda vendit.**
8. **Të merret parasysh prioritizimi i nënsektorëve më të rëndësishëm në industrinë e përpunimit duke u përqëndruar në minimizimin e deficitit tregtar, me qëllim depërtimin në tregun ndërkombëtar. Diversifikimi i skemave mbështetëse të granteve dhe produkteve bankare gjithashtu, për sa i përket nënsektorëve të bujqësisë:**
 - » **Përpunimi i frutave.** Industria e përpunimit të lëngjeve kërkon investime në linja moderne (pasterizim të lëngjeve dhe paketim *tetra pack*) për përpunimin e frutave. Kjo industri duhet të mundësojë prodhimin e koncentreve të frutave për eksport. Kjo industri do të përfshijë gjithashtu përpunimin e frutave të pyjeve (boronica, manaferra, dëllinja e zezë, mjedra, etj.) aty ku kërkesa po rritet;
 - » **Përpunimi i domates.** Industria e përpunimit të salcës kërkon shtim të investimeve në teknologjitë bashkëkohore të përpunimit për prodhimin e formave të ndryshme të salcave ashtu si kërkohe në tregun botëror. Ndërkohë, zhvillimi i këtij nën-sektori do të plotësojë kërkesën e tregut të brendshëm duke ulur ndjeshëm vëllimet e mëdha të importit;
 - » **Përpunimi i gështenjës.** Proceset e përpunimit të gështenjës shihen si një domosdoshmëri në rritjen e vlerës së këtij produkti. Investimet në procesin e përpunimit të plotë të gështenjave, d.m.th tharja dhe zhveshja e plotë, si dhe përpunimi i miellit për industrinë e ëmbëlsirave, janë nevoja të menjëhershme në këtë sektor.
 - » **Përpunimi i BMA.** Pavarësisht faktit që ky

sektor ka patur arritje në këto vite, ekziston ende një mundësi për të rritur volumin e produkteve të përpunuara, d.m.th. përpunimin e disa bimëve mjekësore të kërkuara nga industria farmaceutike, pra prodhimin e esencave. Kjo kërkon si *mirëqeverisje të sektorit* ashtu edhe investime në distilëri moderne për prodhimin e esencave. Prodhimi i esencave do të jetë një mundësi e mirë për zhvillimin e industrisë farmaceutike shqiptare.

MENAXHIMI I BIZNESIT, OPERACIONET DHE ARSIMIMI

9. **Zhvillimi i profileve të investimeve (shih shtojcat) dhe kartave teknologjike në agro-përpunim në mënyrë që të lehtësohen vendimet dhe aktivitetet e investimeve. Studimi (në shtojcë) përmban shembuj të kartave teknologjike që korrespondojnë me katër produktet strategjike të identifikuar të cilat mund të përdoren si pikë referimi për investime të mundshme në sektor.**
10. Të investohet në zvogëlimin e mospërputhjes së aftësive - përmes arsimimit profesional bujqësor, trajnimit profesional dhe programeve të të mësuarit gjatë gjithë jetës për të formuar punonjës të aftë në agrobiznes dhe personel profesional. Kjo mund të jetë pjesë e një qasjeje të integruar të përshtatur për sektorin, mbështetur nga qeveria në drejtim të prodhimit vendas, i cili më pas mund të gjenerojë më shumë fokus nga universitetet në përgatitjen e përmirësimit të planeve mësimore standarde për agro-përpunimin dhe futjen e sistemit dypalësh (arsimim profesional dhe praktikë profesionale në një kompani) si një mjet për të përgatitur specialistë të vazhdueshëm për të gjithë sektorin.

ÇËSHTJE INSTITUCIONALE DHE LIGJORE

11. **Pavarësisht se përmirësimet në legjislacion kanë qenë thelbësore, kërkohe përmirësimet të mëtejshme për plotësimin e kuadrit ligjor për produktet organike dhe emërtimet e mbrojtura të origjinës, treguesit gjeografikë dhe specialitetet tradicionale të garantuara, si dhe për vreshtat dhe verën, dhe për të siguruar kapacitetin institucional dhe administrativ për zbatimin e tij. Më konkretisht, etapat e mëposhtme pritet të arrihen në muajt e ardhshëm të cilat do të sigurojnë më shumë mbështetje për produktet vendase:**
 - » Ndryshimi dhe harmonizimi i Ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre” me dispozitat e Rregullores së BE 2018/848 “Për prodhimin organik” e cila pritet të hyjë në fuqi nga 1 janar 2021.
 - » Miratimi i projektligjit “Për vreshtat dhe verën” i cili ka qenë objekt i njoftimit dhe konsultimit publik që prej qershor të vitit 2020.
 - » Rritje e kapaciteteve të AKU në verifikimin e përputhshmërisë dhe kontrollin e produkteve me Emërtim Origjine, Tregues Gjeografik dhe Specialitet Tradicional të Garantuar.
 - » Harmonizimi i të dhënave për Agropërpunimin mes të gjithë institucioneve raportuese,

MBZHR, INSTAT, DPD, QKB, BSH, bankat e nivelit dytësor, etj. për analiza më të mira sektoriale dhe orientim të politikave.

AKSESI NË FINANCIM

12. **Përdorimi i skemave të garancisë së kredisë është rritur gjatë viteve, por është ende i ulët për shkak të faktit se ato nuk janë tërheqëse për sa i përket kostove edhe pse ato ofrojnë lehtësinë e ndarjes së rrezikut me bankat dhe ulin mbulimin e kolateralit në një nivel të caktuar. Një thjeshtim i procedurave dhe ulja e kostove administrative të këtyre skemave, mund t'i bëjë ato më tërheqëse dhe do të lehtësonte qasjen në financim për një numër më të madh biznesesh.**
13. **Krijimi i skemave të mbulimit të sigurimeve për produktet e biznesit bujqësor duke prezantuar shtetin si ndërmjetës. Nga rajoni për shembull⁵⁵, Qeveria e Maqedonisë së Veriut sot paguan 60% të primit të sigurimit dhe 40% paguhet nga fermeri. Për të ngritur sektorin e sigurimeve, Ministria e Bujqësisë sugjerohet të ketë një bazë informacioni mbi të dhënat, rreziqet për secilin nën-sektor bujqësor, tabelë me të dhëna për kohën, reshjet e shiut, luhatjet e temperaturës, p.sh. nëpërmjet bashkëpunimit me stacionet e sinjalizimit dhe investimeve që menaxhojnë riskun në bujqësi.**

⁵⁵ Agjencia e Supervizimit të Sigurimeve (2015) “Agriculture Insurance in Macedonia”

SUGJERIME NGA ANËTARËT E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

1. SHOQATA GJERMANE E INDUSTRIJË DHE TREGTISË NË SHQIPËRI

1. Kushtet e financimit të sektorit nuk janë të përkryera por janë të mjaftueshme për momentin (bankat, AZHBR, AIDA, etj.). Ka një mungesë informacioni tek fermeri për mundësitë që ekzistojnë sot në treg. Bashkitë mund të luanin një rol të madh në këtë drejtim, duke marrë ndoshta fonde nga AZHBR vetëm për procesin e informimit dhe të kontrolloheshin nga një strukturë qendrore p.sh. AIDA në lidhje me efikasitetin e këtyre fondeve. Ndoshta një strukturë e posaçme, por kjo do të kërkonte kohë edhe për shkak të kuadrit ligjor.
2. Problemi i kostove dhe volumit të prodhimit nga fermeri si pasojë e ekonomisë së shkallës (toka e fragmentuar). Sigurisht që subvencionet në makineri pajisje, farëra dhe pesticide si dhe së fundmi karburanti do influencojnë pozitivisht, por nuk do

sjellin zgjidhjen përfundimtare, për të rritur eksportet bujqësore në nivel të kënaqshëm. Problemi i ekonomisë së shkallës do të vazhdojë të mbetet. Ligji për kooperativat në fakt duhet ta zgjidhte disi këtë problematikë, por mungesa e besueshmërisë dhe hyrja në marrëdhënie kontraktuale me fqinjin në mungesë të gjykatave i step fermerët të futen në ortakëri. Dhe nëse kemi disa shembuj sot, ato nuk janë në fakt cooperativa të mirëfillta në frymë të ligjit të vitit 2012. Ato janë më shumë një marrëdhënie grumbullues - fermer. Dhe kjo marrëdhënie funksion sipas rregullave të tregut të lirë ndoshta me disa kontrata para-prake për prodhimin e produkteve specifike, por që në fund çmimin dhe rregullat i përcakton grumbulluesi, pasi oferta është më e madhe se kërkesa ose ofertuesi (fermeri) nuk e njeh kërkesën e vërtetë. Këtë informacion e ka grumbulluesi. Ndaj informacioni mbi tregun, gjetja e klientit është shumë më e

rëndësishme se të gjithë faktorët e sipërpërmendur, sigurisht duke plotësuar standardin që kërkon blerësi - një zgjidhje e mundshme do të ishte ngritja e një burse bujqësore, kjo do të sillte një transparencë të madhe dhe do të përfshinte një numër të madh fermerësh. Sigurisht do të rritej dhe konkurrueshmëria. Nga ana tjetër nuk do të hidheshin më produktet për shkak të çmimin të ulët pasi produktet do të tregtoheshin një vit përpara se të prodhoheshin nëpërmjet titujve dhe kontratave, të cilat sigurisht duhet të sigurohen në kompani sigurimi dhe banka. Nëse fermeri ka kontrata të mbyllura një vit përpara prodhimit, edhe aksesimi në banka bëhet më i lehtë. Në këtë rast fermeri ka një plan biznesi. Tregu i thjeshtë i produktet bujqësore lidhet me kosto të larta magazinimi, që sigurisht nuk mund t'i përmbushë çdo fermer në Shqipëri, por grumbulluesit e mëdhenj të cilët e njohin tregun mund të blejnë titujt dhe më pas të magazinonjë ose përpunojnë produktet.

2. BASHKIMI I DHOMAVE TË TREGTISË DHE INDUSTRIJË SË SHQIPËRISË

1. Marrja e një vendimi për lejimin e importit vetëm të zogjve 24-orësh dhe miratimin e

rregullave dhe udhëzimeve për manaxhimin e situatës së krijuar;

2. Forcimin e punës të të gjitha institucioneve dhe në veçanti të shërbimit veterinar dhe të AKU, ku çdo institucion të kryejë verifikimet përkatëse, që nga licencimet e deri tek cënimet e bio-sigurisë dhe shëndetit të konsumatorit;
3. Nxitja e kultivimit të tokave të papunuara me kultura foragjere për blegtorinë, nëpërmjet incentivave të shtetit;
4. Subvencionimin e mishit të shpendëve, ku në vendet fqinje si Maqedonia e Veriut, ky subvencion shkon deri në 30 cent për kg mish zogju.

3. DONI FRUITS SHPK

TAM (taksa e ambalazhit) aktualisht është 100 lek kg për lëndë të parë dhe 350 lek kg për produkt të gatshëm në import. Propozojmë që të hiqet TAM për ambalazh plastike për produkte agro. Për shkak të rritjes së nevojës për ruajtje të produkteve bujqësore - mollë, dardhë, kiwi, shegë, rrush, etj., kjo mundëson të ruajmë produktet me kushte të volitshme në frigorifer dhe të rrisim vlerën e produktit kur ka nevojë tregu si dhe mundëson ndaljen e importit të këtyre produkteve.

SHTOJCA 1

Investime strategjike në BMA

INVESTIME STRATEGJIKE NË AGROBIZNES		
Sektori:	Bimët Mjekësore dhe Aromatike	
Investimi në teknologji:	Prodhimi i esencave nga sektori i BMA-ve	
Teknologjia:	Instalim Distilerie për përpunimin e BMA-ve	
Numri i distilerve të nevojshme:	2 Distileri me kapacitet 150 ton	
Vlera e financimit per distileri:	3 milionë Euro	
Kërkesa e tregut për Shqipërinë:	400 ton esenca (120 mil Euro)	
Produktet e esencave	BMA lëndë e parë	Produktet e esencave
	Dafinë	30 %
	Lavanda	40%
	Dëllenjë e zeze	15%
	Elikrisium	10%
	Të tjera	5%
Nevoja për esencë	Skeda Teknologjike	Nevoja për esencë
120 ton esencë dafine	1 ton dafine = 5 kg esencë	120 ton esencë dafine
160 ton esencë lavanda	1 ton lavanda = 10 kg esencë	160 ton esencë lavanda
60 ton esencë dëllenje	1 ton dëllenje = 14 kg esencë	60 ton esencë dëllenje
40 ton elikrisium	1 ton elikrisium = 1 kg esencë	40 ton elikrisium
20 ton të tjera	miks	20 ton të tjera
Standardi i cilësisë dhe sigurisë së kërkuar	☐ Global G.A.P. ☐ IFS ☐ HACCP x Organike x Standard tjetër: NOP (USDA)	
Tregu kryesor i shitjeve: » Rajonal (AL, BH, KS, MK, SRB) » Ndërkombëtar	☐ Treg lokal dhe rajonal ☒ Kërkesë nga furnizues ndërkombëtar	
Komente shpjeguese	Kërkesa për esencat e bimëve mjekësore të kërkuara nga tregu botëror kërkon një harmonizim të hallkave ndërvepruese në zinxhirin e vlerës së BMA-ve. Ky plotësim i kërkesës së tregut kërkon një investim në distileri në vlerën rreth 6 mil Euro, mbështetur kjo me investime në fermë në një sipërfaqej rreth 11.000 ha në një vlerë të përafërt me rreth 50 milionë Euro.	

SHTOJCA 2

Investime Strategjike në Përpunimin e Gështenjës

INVESTIME STRATEGJIKE NË AGROBIZNES		
Sektori:	Përpunimi i gështenjës	
Investimi në teknologji:	Përpunimi i gështenjës për kokërr të zhveshur dhe miell	
Teknologjia:	Linjë për trajtimin e gështenjës (përfshirë ambientet frigoriferike dhe tunelin ngrirës)	
Numri i fabrikave të nevojshme:	1 fabrikë me kapacitet 8-10 ton/ora	
Vlera e financimit për linjë:	1,5 milionë Euro	
Kërkesa e tregut për Shqipërinë:	4000 ton gështenjë	
Prodhimi i gështenjës së zhveshur dhe miell për industrinë	Lëndë e parë	Prodhimi i gështenjës së zhveshur dhe miell për industrinë
	Gështenjë	100 %
Nevoja për produkt	Skeda Teknologjike	Nevoja për produkt
Gështenjë e zhveshur 3000 ton	1 ton gështenjë = 500 kg gështenje te zhveshur (1/2 pjekur)	Gështenjë e zhveshur 3000 ton
Miell gështenje 1000 ton	1 ton gështenjë = 400 kg miell gështenjë (procesuar pas pjekjes)	Miell gështenjë 1000 ton
Standardi i cilësisë dhe sigurisë së kërkuar	☐ Global G.A.P. ☐ IFS x HACCP x Organike x Standard tjetër: ISO 22000	
Tregu kryesor i shitjeve: Rajonal (AL, BH, KS, MK, SRB) Ndërkombëtar	x Treg lokal dhe rajonal ☒ Kërkesë nga furnizues ndërkombëtar	
Komente shpjeguese	Kërkesa e tregut të vendit dhe atij ndërkombëtar për gështenja është shumë e lartë, duke qënë se përdoret si për përdorim direkt ashtu edhe për industrinë e ëmbëlsirave. Afërsisht kërkohet të kultivohen rreth 3.500 ha gështenja për të siguruar konsumin vendas dhe kërkesën e eksportit. Bazuar në Kartën Teknologjike, kosto për prodhimin e 1 ha me gështenja është rreth 8.000 euro/ha. Nisur nga të dhënat statistikore në Shqipëri ekzistojnë rreth 2.500 ha me gështenja. Pra, kërkohet një investim prej 8 milion euro për shtimin e 1.000 ha me gështenja për të siguruar prodhimin e lëndës së parë për të mbuluar kërkesën e tregut vendas dhe tregun e eksportit.	

SHTOJCA 3

Investimet Strategjike në Përpunimin e Domates

INVESTIME STRATEGJIKE NË AGROBIZNES		
Sektori:	Përpunimi i domates	
Investimi në teknologji:	Prodhimi i salcës së domates	
Teknologjia:	Linjë përpunimi salce (pure aseptike)	
Numri i fabrikave të nevojshme:	1 fabrikë me kapacitet 5-7 ton/ora	
Vlera e financimit për linjë:	1.2 milionë Euro	
Kërkesa e tregut për Shqipërinë:	2000 ton salcë domate	
Prodhimi i salcës	Lëndë e parë	Prodhimi i salcës
	Domate (varieteti Roma, Giuleta, San Marziano, etj.)	100 %
Nevoja për salce domate në Shqipëri	Skeda Teknologjike	Nevoja për salce domate në Shqipëri
2000 ton salcë domate	1 ton domate = 600 kg salcë	2000 ton salcë domate
Standardi i cilësisë dhe sigurisë së kërkuar	☐ Global G.A.P. ☐ IFS x HACCP ☐ Organike x Standard tjetër: ISO 22000	
Tregu kryesor i shitjeve: Rajonal (AL, BH, KS, MK, SRB) Ndërkombëtar	x Treg lokal dhe rajonal X Kërkesë nga furnizues ndërkombëtar	
Komente shpjeguese	Kërkesa e tregut shqiptar për salcë domate është e lartë, por problematika qëndron në sigurimin e lëndës së parë. Afërsisht kërkohet të kultivohen rreth 70-80 ha domate për salcë për të siguruar konsumin vendas. Ndërkohë që kërkesa për eksport është 3 herë më e lartë se konsumi kombëtar, pra kërkohet rreth 200-250 ha kultivim domate për salcë. Bazuar në Kartën Teknologjike, kosto për prodhimin e 1 ha domate për salcë është rreth 8.000 euro/ha. Pra, kërkohet një investim prej 560,000 euro për sigurimin e lëndës së parë për të siguruar kërkesën e tregut vendas, dhe 1,6 mil euro për të siguruar edhe tregun e eksportit.	

SHTOJCA 4

Investimet Strategjike në Përpunimin e Frutave

INVESTIME STRATEGJIKE NË AGROBIZNES		
Sektori:	Përpunimi i frutave (lëngje frutash dhe koncentrat)	
Investimi në teknologji:	Prodhimi lëngjeve të frutave dhe koncentratit	
Teknologjia:	Instalim linje për prodhimin e lëngjeve dhe koncentratit të lëngjeve	
Numri i linjave të prodhimit të lëngjeve dhe koncentratit të nevojshme:	1 Fabrikë për prodhim lëngjesh dhe koncentratit me kapacitet 8-10 ton/ora	
Vlera e financimit për një linjë:	1,8 milionë Euro	
Kërkesa e tregut për Shqipërinë:	20-24 milionë litra lëng	
Prodhimi kombëtar:	Rreth 18 mil litra/vit	
Importi i lëngjeve dhe koncentratit:	Rreth 5-6 mil litra/vit (përfshirë koncentratin e konvertuar në lëng)	
Produktet sipas llojit	Lëndë e parë	Produktet sipas llojit
	Mollë	25 %
	Portokalli	50%
	Qershia	10%
	Dardha	5%
	Të tjera (fruta pylli)	10%
Nevoja për Lëngje	Skeda Teknologjike	Nevoja për Lëngje
6 mil litra lëng molle	1 ton mollë = 500 litra lëng molle	6 mil litra lëng molle
12 mil litra lëng portokalli	1 ton portokall = 600 litra lëng portokalli	12 mil litra lëng portokalli
2.4 mil litra lëng qershie	1 ton qersh = 400 kg lëng qershie	2.4 mil litra lëng qershie
1.2 mil litra lëng dardhe	1 ton dardhë = 500 litra lëng dardhe	1.2 mil litra lëng dardhe
2.4 mil litra lëng miks	miks	2.4 mil litra lëng miks
Standardi i cilësisë dhe sigurisë së kërkuar	☐ Global G.A.P. ☐ IFS x HACCP ☐ Organike x Standard tjetër: ISO 22000	
Tregu kryesor i shitjeve: Rajonal (AL, BH, KS, MK, SRB) Ndërkombëtar	x Treg lokal dhe rajonal X Kërkesë nga furnizues ndërkombëtar	
Komente shpjeguese	Kërkesa për lëngje të freskët frutash është relativisht e lartë ku rreth 3 mil litra importohen (pa përfshirë koncentratin). Realizimi i këtij projekt investimi kërkon mbështetje të prodhimit të lëndës së parë, pra mbjelljen e rreth 1.000-1.200 ha pemëtore (kryesisht me portokalle), me një kosto rreth 7-8 milionë Euro. Në mënyrë që kjo industri prodhuese të jetë konkurruese në tregjet ndërkombëtare kërkon investime nga industria e qelqit duke qënë se amballazhi përbën rreth 40% të kostos së prodhimit. Mundësi e lartë eksporti.	

SHTOJCA 5

Kosto për ngritjen e një parceleje me elikrisium						
	Përshkrimi	Njësia	Njësi/ha	ALL/njësi	ALL/ha	Pesha e zërave të investimit
A	Punime të mekanizuara për përgatitjen e tokës dhe mbjelljen e parcelës					
1	Plugim qilizëm 70 cm	ha	1	12.000	12.000	2,18%
2	Plugim i dytë	ha	1	12.000	12.000	2,18%
3	Frezim	ha	1	10.000	10.000	1,82%
4	Kultivim	ha	1	12.000	12.000	2,18%
	Total punime të mekanizuara				46.000	8,4%
B	Punime me krahë për përgatitjen e tokës dhe mbjelljen e parcelës					
1	Piketim parcele	norma pune	2	1,500	3,000	0.5%
2	Shpërndarje plehu organik në gropë	norma pune	4	1,500	6,000	1.1%
3	Banjëzim fidani	norma pune	0.5	1,500	750	0.1%
4	Mbjellje fidanësh	norma pune	10	1,500	15,000	2.7%
5	Prashitje	norma pune	13	1,500	19,500	3.6%
6	Korrje	norma pune	20	1,500	30,000	5.5%
7	Tharje	norma pune	8	1,500	12,000	2.2%
	Total punime me krahë				86,250	15.7%
C	Materiale dhe inpute për parcelë					
1	Fidane	rrënjë	5,000	8	40,000	7.3%
3	Sistemi i ujitjes	lekë			280,000	51.0%
4	Pleh organik	kv	300	250	75,000	13.7%
5	DAP	kv	3	5,000	15,000	2.7%
6	Plehra azotike	kv	2	3,500	7,000	1.3%
	Total materiale				417,000	75.9%
	TOTAL PARCELE ME ELIKRISIUM				549,250	100%

SHTOJCA 6

Kosto për ngritjen e një pemëtoreje me gështenja						
	Përshkrimi	Njësia	Njësi/ha	ALL/njësi	ALL/ha	Pesha e zërave të investimit
A	Punime të mekanizuara për përgatitjen e tokës dhe mbjelljen e pemëtores					
1	Taracime	ha	1	14,000	14,000	1.40%
2	Drenazhim	ha	1	28,000	28,000	2.80%
3	Plugim qilizëm 70 cm	ha	1	12,000	12,000	1.20%
	Total punime të mekanizuara				54,000	5.4%
B	Punime me krahë për përgatitjen e tokës dhe mbjelljen e pemëtores					
1	Piketim parcele	norma pune	4	1,000	4,000	0.4%
2	Hapje grope	nr	600	100	60,000	6.0%
3	Shpërndarje plehu organik në gropë	nr	600	30	18,000	1.8%
4	Mbjellje e fidanëve	nr	600	100	60,000	6.0%
	Total punime me krahë				142,000	14.2%
C	Materiale dhe inpute për pemëtoren					
1	Fidanë dy-vjecarë	rrënjë	600	650	390,000	39.0%
2	Restela për mbështetjen e fidanëve	copë	600	25	15,000	1.5%
3	Sistemi i ujitjes	lekë			280,000	28.0%
4	Pleh organik	kv	200	250	50,000	5.0%
5	Pleh kimik fosforik	kv	5	8,400	42,000	4.2%
6	Pleh kimik potasik	kv	4	7,000	28,000	2.8%
	Total materiale				805,000	80.4%
	TOTAL PEMËTORE ME GËSHTENJA				1,001,000	100%

SHTOJCA 7

Kosto për ngritjen e një parceleje me lavantë						
	Përshkrimi	Njësia	Njësi/ha	ALL/njësi	ALL/ha	Pesha e zërave të investimit
A	Punime të mekanizuara për përgatitjen e tokës dhe mbjelljen e parcelës					
1	Plugim qilizëm 70 cm	ha	1	12,000	12,000	2.12%
2	Plugimi i dytë	ha	1	12,000	12,000	2.12%
3	Frezim	ha	1	10,000	10,000	1.77%
4	Kultivim	ha	1	12,000	12,000	2.12%
	Total punime të mekanizuara				46,000	8.1%
B	Punime me krahë për përgatitjen e tokës dhe mbjelljen e parcelës					
1	Piketim parcele	norma pune	2	1,500	3,000	0.5%
2	Shpërndarje plehu organik në gropë	norma pune	4	1,500	6,000	1.1%
3	Banjëzim fidani	norma pune	0.5	1,500	750	0.1%
4	Mbjellje fidanësh	norma pune	10	1,500	15,000	2.7%
